Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan

Fakulteti Juridik / Studimet Master

Programi Juridiko - Penal

PUNIM DIPLOME

Tema: Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve në territorin e Gjykatës Themelore të Gjilanit gjatë periudhës 2020-2024

Mentori:

Prof.Asoc.Dr.Albulena Hajdari Krasniqi

Kandidatja:

Monika Hyseni

Gjilan, Shtator 2026

Deklarata e autorësisë

Unë, Monika Hyseni, deklaroj me përgjegjësi se në këtë punim nuk është përdorur material i huaj pa cituar burimin përkatës dhe se çdo pjesë e huazuar nga autorë të tjerë është shënuar dhe referuar në mënyrë të qartë, sipas standardeve të pranueshme të citimit.

Jam plotësisht përgjegjëse për përmbajtjen dhe për saktësinë e të dhënave të paraqitura në punim.

Falënderime dhe mirënjohje

Përfundimi i këtij punimi përbën një hap të rëndësishëm në rrugëtimin tim akademik. Për këtë arsyë, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time ndaj të gjihë atyre që më kanë mbështetur gjatë studimeve dhe gjatë përgatitjes së këtij punimi.

Një falënderim i veçantë i kushtohet mentores sime, prof. Albulena Hajdari Krasniqi për udhëzimet, këshillat dhe mbështetjen e dhënë gjatë punimit dhe përfundimit të kësaj teme.

Falënderoj edhe familjen time, për dashurinë, durimin dhe përkrahjen e pakushtëzuar gjatë gjithë kohës sa kam punuar këtë temë diplome si dhe gjatë tërë periudhës së studimeve. Pa mbështetjen tuaj, ky proces nuk do të ishte i mundur. Kontributi juaj ka qenë një motivim i madh për të përfunduar këtë temë me sukses.

Me respekt,
Monika Hyseni

Abstrakt

Ky studim trajton masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve në territorin e Gjykatës Themelore të Gjilanit gjatë periudhës 2020-2024. Fokusi i studimit është përcaktimi i llojeve, frekuencës dhe efektivitetit të këtyre masave si instrumente alternative ndaj dënimeve tradicionale, si dhe shqyrtimi i rolit të tyre si alternativa ndaj masave dhe dënimeve të tjera, me vëmendje të veçantë ndaj parandalimit të përsëritjes së veprave penale dhe riintegrimit të të miturve në shoqëri. Përmes analizës së të dhënave statistikore, dhe praktikës së institucioneve përkatëse, studimi identifikon tendencat në zbatimin e masave si mbikëqyrja nga prindi apo kujdestari, mbikëqyrja nga organet dhe institucionet kompetente, si dhe bashkëpunimi me institucionet përkatëse sociale dhe arsimore.

Hulumtimi mbështetet në analizën e të dhënave statistikore gjyqësore dhe në shqyrtimin e praktikës së institucioneve kompetente. Rezultatet tregojnë një rritje graduale të përdorimit të masave alternative dhe nevojën për përmirësim të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe monitorimit. Metodologjia e përdorur përfshin statistikat gjyqësore dhe krahasimin e të dhënave.

Përmes këtij kombinimi të të dhënave cilësore dhe sasiore, është bërë e mundur të kuptohet jo vetëm aspekti formal-ligjor i zbatimit të këtyre masave, por edhe ndikimi i tyre në sjelljen dhe rehabilitimin e të miturve. Rezultatet tregojnë një rritje të përdorimit të këtyre masave në vitet e fundit të periudhës së analizuar, veçanërisht në vitet 2023 dhe 2024.

Fjalët kyçe: Masat e mbikëqyrjes, të mitur, recidivizëm, riintegrim, statistika gjyqësore, prind apo kujdestar, bashkëpunim ndërinstitucional.

Abstract

This study examines measures of enhanced supervision for juveniles within the jurisdiction of the Basic Court of Gjilan during the 2020–2024 period. The study focuses on determining the types, frequency, and effectiveness of these measures as alternatives to traditional penalties, as well as examining their role as alternatives to other measures and sanctions, with particular emphasis on preventing recidivism and reintegrating juveniles into society. Through an analysis of statistical data and the practices of relevant institutions, the study identifies trends in the implementation of measures such as supervision by parents or guardians, supervision by competent bodies and institutions, and cooperation with relevant social and educational institutions.

The research is based on the analysis of judicial statistical data and a review of the practices of competent institutions. The results indicate a gradual increase in the use of alternative measures and a need to improve supervision and monitoring mechanisms. The methodology employed involves judicial statistics and data comparison.

Through this combination of qualitative and quantitative data, it has been possible to understand not only the formal-legal aspects of implementing these measures but also their impact on the behavior and rehabilitation of juveniles. The results indicate an increase in the use of these measures during the final years of the analyzed period, particularly in 2023 and 2024.

Keywords: Supervision measures, juveniles, recidivism, reintegration, judicial statistics, parent or guardian, inter-institutional cooperation.

Lista e shkurtesave:

BE - Bashkimi Evropian;

IKD - Instituti i Kosovës për Drejtësi;

KDF- Konventa për të Drejtat e Fëmijës

KDMRK - Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Republikës së Kosovës;

KEDNJ - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës;

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara;

QPS - Qendra për Punë Sociale;

Rregullat e Pekinit - Rregullat Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur;

Rregullat e Riadit - Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e delikuencës së të miturve;

SHSK - Shërbimi Sprovues i Kosovës;

UNICEF - United Nations Children's Fund.

Lista e tabelave:

Tabela 1: Numri i rasteve të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve për vitin 2020, 2021, 2022, 2023, 2024.

Tabela 2: Veprat penale për të cilat janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve.

Tabela 3: Mosha (viti i lindjes) së të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar.

Tabela 4: Gjinia e të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar.

Lista e grafikonëve:

Grafikoni 1: Paraqitja e numrit të rasteve (2020-2024)

Grafikoni 2: Mosha e të miturve.

Përmbajtja

Deklarata e autorësisë ii

Falënderime dhe mirënjohje iii

Abstrakt iv

Lista e shkurtesave: vi

Lista e tabelave: vii

Tabela 1: Numri i rasteve të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve për vitin 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 vii

Tabela 2: Veprat penale për të cilat janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve. vii

Tabela 3: Mosha (viti i lindjes) së të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar. vii

Tabela 4: Gjinia e të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar. vii

Lista e grafikonëve: vii

Grafikoni 1: Paraqitja e numrit të rasteve (2020-2024) vii

Grafikoni 2: Mosha e të miturve. vii

PJESA HYRËSE 11

1. Hyrje 11

2. Identifikimi i problemit dhe qëllimi i punimit 13

3. Objektivat e punimit 14

4. Hipotezat dhe pyetjet kërkimore 14

5. Metodologjia e punës 15

Kapitulli I 18

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME TË MASAVE TË MBIKËQYRJES SË SHTUAR NDAJ TË MITURVE 18

1. Përkufizimi i masave të mbikëqyrjes së shtuar 18

2. Llojet e masave të mbikëqyrjes së shtuar 19

3. Karakteristikat e masave të mbikëqyrjes së shtuar 21

4. Kushtet për shqiptimin e masave të mbikëqyrjes së shtuar 22

5. Autoriteti që i shqipton masat e mbikëqyrjes së shtuar 23

6. Procedura e shqiptimit të masave të mbikëqyrjes së shtuar 26

7. Kohëzgjatja e masave të mbikëqyrjes së shtuar 27
8. Zëvendësimi i masave të mbikëqyrjes së shtuar 28
9. Pushimi i masave të mbikëqyrjes së shtuar 28
10. Roli i Shërbimit Sprovues dhe Qendrës për Punë sociale në ndërlidhje me masat e mbikëqyrjes së shtuar 29

Kapitulli II 30
VËSHTRIMI HISTORIK DHE KRAHASUES I MASAVE TË MBIKËQYRJES SË SHTUAR NDAJ TË MITURVE 30
1. Një historik i shkurtër i masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve në përgjithësi 30
2. Një historik i shkurtër i masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve në Kosovë 31
3. Vështrimi krahasues i masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve 32
3.1. Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve sipas legjislacionit penal të Shqipërisë 33
3.2. Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve sipas legjislacionit penal të Kroacisë 35
3.3. Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve sipas legjislacionit penal të Italisë 36
4. Veçoritë e përbashkëta dhe dalluese në vështrim të rregullimit ligjor të masave të mbikëqyrjes së shtuar në Kosovë, Shqipëri, Kroaci dhe Itali 38
5. Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve sipas akteve ndërkombëtare 40

Kapitulli III 43
MASAT E MBIKËQYRJES SË SHTUAR NDAJ TË MITURVE NË GJYKATËN THEMELORE TË GJILANIT GJATË PERIUDHËS 2020-2024 43
1. Numri dhe dinamika e masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve 43
2. Veprat penale për të cilat janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar 45
3. Disa të dhëna personale të të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar 47
3.1. Mosha 47
3.2. Gjinia 50
3.3. Niveli arsimor 51
3.4. Statusi social e familjar 52
Përfundime dhe rekomandime 53
Përfundimet: 53
Rekomandimet: 55

Libra dhe artikuj shkencorë 56
Akte juridike 56
Burime të tjera..... 57

PJESA HYRËSE

1. Hyrje

Në sistemet moderne të drejtësisë penale, trajtimi i të miturve që shkelin ligjin kërkon një qasje të veçantë, që fokusohet më shumë në rehabilitimin dhe mbështetjen sociale sesa në ndëshkimin penal. Në këtë kontekst, masat e mbikëqyrjes së shtuar përbëjnë një alternativë të rëndësishme ndaj dënimit me burgim, pasi synojnë edukimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë zbatimin e masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve në territorin e Gjykatës Themelore të Gjilanit gjatë periudhës 2020-2024, me fokus në përmbushjen e qëllimeve rehabilituese dhe parandalimin e recidivizmit. Përmes një analize të thelluar teorike, krahasimore dhe empirike, punimi shqyrton aspekte të rëndësishme ligjore, institucionale dhe praktike që lidhen me këto masa.

Në sistemet moderne juridike, përfshirë edhe Republikën e Kosovës, është rritur vëmendja ndaj përdorimit të masave alternative ndaj burgimit në rastet që përfshijnë të miturit. Këto masa kanë rëndësi të veçantë në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, pasi përmes tyre synohet jo vetëm përgjegjësia juridike për veprën e kryer, por edhe edukimi dhe integrimi i tyre në shoqëri. Në këtë kuadër, privimi i lirisë së të miturit duhet të konsiderohet si masë e fundit, e cila zbatohet vetëm atëherë kur masat e tjera nuk mund të përmbushin në mënyrë të mjaftueshme qëllimin e trajtimit.

Zhvillimi i standardeve ndërkombëtare ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndryshimin dhe avancimin e mënyrës së trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin. Dokumente të rëndësishme ndërkombëtare, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Rregullat e Pekinit dhe udhëzime të tjera ndërkombëtare, kanë vendosur parime dhe standarde që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të miturve dhe promovimin e masave alternative në vend të dënimit me burgim.

Në Republikën e Kosovës, çështja e trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin rregullohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, i cili përcakton procedurat, masat dhe institucionet përgjegjëse për trajtimin e kësaj kategorie. Ky Kod synon të sigurojë një qasje më humane dhe edukative ndaj të miturve, duke promovuar përdorimin e masave alternative dhe duke reduktuar përdorimin e dënimit me burgim.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë masat si alternativë ndaj dënimit me burgim dhe aplikimin e tyre në praktikën gjyqësore, duke shqyrtuar rëndësinë dhe efektivitetin e tyre në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Përmes këtij punimi synohet të paraqitet roli i këtyre masave në rehabilitimin e të miturve dhe parandalimin e përsëritjes së veprave penale.

2. Struktura e punimit

Punimi përbëhet nga tre kapituj kryesorë, si në vijim:

Në **kapitullin e parë** me titull "**Vështrime të përgjithshme të masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve**", trajtohet kuadri teorik dhe juridik i masave të mbikëqyrjes ndaj të miturve, përfshirë përkufizimin, llojet e masave, procedurat e shqiptimit, autoritetet kompetente dhe kohëzgjatjen e tyre.

Në **kapitullin e dytë** me titull "**Vështrimi historik dhe krahasues i masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve**" trajtohet zhvillimi historik dhe analiza krahasuese e masave të mbikëqyrjes ndaj të miturve, duke u mbështetur në legjislacionin dhe praktikat e Kosovës, Shqipërisë, Kroacisë dhe Italisë, si dhe përputhshmërinë me aktet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.

Në **kapitullin e tretë** me titull "**Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve në Gjykatën Themelore të Gjilanit gjatë periudhës 2020-2024**", u bëhet një analizë praktike aplikimit të masave të mbikëqyrjes së shtuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Themelore të Gjilanit, duke u bazuar në të dhënat dhe statistikat nga periudha 2020-2024, si dhe interpretimin e tyre në kontekstin e sistemit të drejtësisë ndaj të miturve dhe rëndësinë e tyre në rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet bashkëpunimit ndërinstitucional, përfshirjes së Qendrave për Punë Sociale, Shërbimit Sprovues, institucioneve arsimore dhe familjes në procesin e rehabilitimit të të miturve. Zgjedhja e kësaj teme buron nga nevoja për të thelluar kuptimin mbi funksionimin e masave alternative në sistemin penal për të mitur në Kosovë dhe për të ofruar rekomandime konkrete për përmirësimin e politikave ekzistuese. Punimi përveç analizës juridike, ka për qëllim të kontribuojë në diskursin shkencor dhe institucional, duke sjellë një perspektivë të bazuar në të dhëna konkrete dhe përvoja praktike nga një rajon i caktuar.

2. Identifikimi i problemit dhe qëllimi i punimit

Trajtimi i të miturve që bien në konflikt me ligjin është një temë që ka fituar rëndësi të veçantë në dekadat e fundit, si në nivelin ndërkombëtar, ashtu edhe në atë vendor. Në qendër të kësaj fushe qëndron ideja se të miturit janë individë në zhvillim dhe për rrjedhojë duhet trajtuar me një qasje ndryshe nga të rriturit dhe atë më shumë përmes masave edukative dhe mbështetëse sesa ndëshkuese.

Në literaturën juridike dhe kriminologjike ndërkombëtare, potencohet se masat alternative ndaj dënimit me burgim, siç është edhe masa e mbikëqyrjes së shtuar, kanë efekt pozitiv në parandalimin e recidivizmit dhe rehabilitimin e të miturve. Organizata si: ***UNICEF***, ***Këshilli i Evropës*** dhe ***Kombet e Bashkuara,*** përmes instrumenteve si Rregullat Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur ***(Rregullat e Pekinit) dhe Rregullat e Riadit,*** kanë theksuar rëndësinë e mos institucionalizimit të të miturve dhe përdorimin e masave që promovojnë integrimin e tyre në komunitet.

Në kontekstin e Kosovës, literatura është ende në zhvillim. Megjithatë, zbatimi i këtyre masave analizohet edhe përmes praktikës gjyqësore. Në këtë punim, analiza bazohet në të dhënat e siguruara nga Gjykata Themelore në Gjilan për periudhën 2020-2024, të cilat paraqesin mënyrën e shqiptimit dhe zbatimit të masës së mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve. Këto studime tregojnë se ndonëse masa në fjalë parashikohet në legjislacion dhe është në përputhje me standardet evropiane, zbatimi i saj në praktikë shpesh has vështirësi për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, mbikëqyrjes së pamjaftueshme dhe bashkëpunimit të dobët ndërinstitucional.

Gjithashtu, studimet akademike në nivel universitar dhe pasuniversitar në Kosovë, në të drejtën penale dhe drejtësisë për të mitur janë fokusuar kryesisht në shqyrtimin teorik të ligjit për të mitur, me më pak fokus në analizën empirike të praktikës gjyqësore në gjykata të veçanta. Kjo lë hapësirë për kontribute të reja hulumtuese që lidhin teorinë me realitetin praktik, siç synon edhe kjo temë diplome.

Në aspektin teorik, baza konceptuale për këtë hulumtim mbështetet në:

a. Parimet e përgjithshme të drejtësisë për të mitur si: mbrojtja e interesit më të mirë të fëmijës, proporcionalitetit, personalizimi i masës dhe rehabilitimi si qëllim parësor.
b. Modeli edukativ në drejtësinë për të mitur, i cili vë theksin në zhvillimin personal dhe social të miturit, në vend të ndëshkimit të thjeshtë.
c. Teoritë kriminologjike të sjelljes devijante të të miturve, si teoria e kontrollit social (Hirschi), teoria e të mësuarit social (Bandura) dhe teoritë e etiketimit (labeling theory), që ndihmojnë në kuptimin e sistemit të drejtësisë mbi formimin dhe sjelljen e të miturve.

3. Objektivat e punimit

Objektivi i përgjithshëm i këtij punimi është analizimi i aplikimit të masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve në Gjykatën Themelore të Gjilanit (2020-2024) dhe ndikimi i tyre në rehabilitimin dhe riintegrimin shoqëror të të miturve.

Objektivat specifike janë:

1. Identifikimi i numrit, llojeve, karakteristikave të rasteve në të cilat janë shqiptuar këto masa;
2. Vlerësimi i efektivitetit të tyre në parandalimin e recidivizmit;
3. Analizimi i rolit dhe bashkëpunimit të institucioneve përgjegjëse (gjykata, prokuroria, qendrat për punë sociale, shërbimi sprovues, familja);
4. Evidentimi i sfidave kryesore në zbatimin praktik të këtyre masave;
5. Krahasimi i praktikave vendore me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e vendeve të tjera dhe
6. Propozimi i përmirësimit të politikave dhe mekanizmave ekzistues për drejtësinë ndaj të miturve.

4. Hipotezat dhe pyetjet kërkimore

a) Hipotezat kërkimore

H1: Masa e mbikëqyrjes së shtuar është aplikuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të rregullt nga Gjykata Themelore e Gjilanit gjatë periudhës 2020-2024.

H2: Zbatimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar ka kontribuar në realizimin e qëllimit edukativ dhe rehabilitues ndaj të miturve në territorin e Gjykatës Themelore të Gjilanit gjatë periudhës 2020-2024.

H3: Institucionet përgjegjëse, veçanërisht Gjykata Themelore e Gjilanit, kanë pasur rol të rëndësishëm në zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve gjatë periudhës 2020-2024.

H4: Ekzistojnë mangësi në koordinimin ndërmjet gjykatës dhe institucioneve të përfshira në zbatimin e masës së mbikëqyrjes së shtuar.

b) Pyetjet kërkimore

1. Cila është frekuenca e shqiptimit të masës së mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve nga Gjykata Themelore e Gjilanit gjatë viteve 2020-2024?
2. Si e vlerësojnë profesionistët e përfshirë efektivitetin e kësaj mase në rehabilitimin e të miturve?
3. Cilat janë sfidat kryesore në zbatimin praktik të masës së mbikëqyrjes së shtuar në territorin e Gjilanit?
4. Sa bashkëpunojnë institucionet relevante në zbatimin e kësaj mase dhe cilat janë mangësitë më të zakonshme të hasura në këtë proces?
5. A ka ndonjë lidhje ndërmjet shqiptimit të kësaj mase dhe nivelit të recidivizmit tek të miturit në këtë rajon?

5. Metodologjia e punës

Për realizimin e kësaj teme të diplomës është përdorur një kombinim i metodave të ndryshme hulumtuese, me synim krijimin e një pasqyre sa më gjithëpërfshirëse dhe objektive të çështjes së analizuar. Qasja është kryesisht cilësore, por përfshin edhe elemente sasiore përmes analizës së të dhënave statistikore.

1. Metoda analitike (juridike)

Kjo metodë është përdorur për të analizuar bazën ligjore që rregullon drejtësinë penale për të mitur në Kosovë, përfshirë Kodin e Drejtësisë për të Mitur (nr.06/L-006) dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me zbatimin e masave edukative, konkretisht masave të mbikëqyrjes së shtuar. Është

bërë gjithashtu krahasim me dokumente ndërkombëtare relevante, si Rregullat e Pekinit dhe Rregullat e Riadit.

2. Metoda përshkruese

Kjo metodë është përdorur për të paraqitur në mënyrë të detajuar aspektet teorike dhe gjendjen aktuale të praktikës gjyqësore në Gjykatën Themelore të Gjilanit lidhur me shqiptimin e këtyre masave. Përmes kësaj metode janë identifikuar karakteristikat kryesore të rasteve dhe mënyra e trajtimit të tyre nga institucionet përgjegjëse.

3. Metoda statistikore

Kjo metodë është aplikuar gjatë shqyrtimit të të dhënave zyrtare të siguruara nga Gjykata, të cilat lidhen me numrin e rasteve ku të miturve u janë shqiptuar masa të mbikëqyrjes së shtuar gjatë viteve 2020-2024. Kjo analizë ka ndihmuar në identifikimin e tendencave dhe përpjesëtimit të kësaj mase në raport me masa të tjera edukative ose ndëshkuese.

4. Metoda krahasuese

Kjo metodë është përdorur për shqyrtimit e të dhënave zyrtare të siguruara nga Gjykata Themelore e Gjilanit, lidhur me numrin e rasteve të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve gjatë periudhës 2020-2024. Përmes krahasimit të të dhënave ndërmjet viteve, me qëllim të evidentimit të ndryshimeve në numrin e rasteve dhe të paraqitjes së zhvillimit të zbatimit të kësaj mase gjatë periudhës së hulumtuar. Gjithashtu, përmes metodës krahasuese është bërë krahasimi i mënyrës së rregullimit të masave të mbikëqyrjes së shtuar në legjislacionin e Kosovës me rregullimet përkatëse në Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kroacisë dhe Republikën e Italisë. Ky krahasim ka mundësuar evidentimin e ngjashmërive dhe dallimeve lidhur me llojet e masave, kushtet e shqiptimit, organet kompetente për zbatimin dhe mbikëqyrjen, si dhe procedurat për përfundimin ose zëvendësimin e tyre.

5. Metoda e analizës së rasteve

Përmes kësaj metode janë analizuar disa vendime gjyqësore konkrete të Gjykatës Themelore të Gjilanit të cilat lidhen me shqiptimin e masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve. Kjo metodë ka mundësuar shqyrtimin e arsyetimit të gjykatës, faktorëve që kanë ndikuar në vendimmarrje, llojit të masave të shqiptuara, si dhe rrjedhës së procedurës. Analiza e rasteve

ka shërbyer për të vlerësuar mënyrën e zbatimit të këtyre masave në praktikën gjyqësore dhe për të lidhur gjetjet praktike me kuadrin teorik dhe juridik të trajtuar në punim.

Kapitulli I

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME TË MASAVE TË MBIKËQYRJES SË SHTUAR NDAJ TË MITURVE

1. Përkufizimi i masave të mbikëqyrjes së shtuar

"Në kuadër të sistemit të masave edukative që zbatohen ndaj të miturve, masat e mbikëqyrjes së shtuar bëjnë pjesë në kategorinë e masave jashtëinstitucionale. Këto masa shqiptohen dhe zbatohen në praktikën gjyqësore me synimin që të ndikojnë në përmirësimin e sjelljes së të miturit, pa qenë e nevojshme izolimi i tij nga mjedisi ku jeton."

Ato bazohen në bindjen se korrigjimi i sjelljes dhe riintegrimi i të miturit arrihen më mirë kur ai vazhdon të jetojë në familje ose në një mjedis tjetër të përshtatshëm shoqëror. Një mjedis i tillë konsiderohet se ushtron ndikim pozitiv në edukimin, rehabilitimin dhe zhvillimin e përgjithshëm të të miturit. Konsiderohet se këto masa paraqesin një mekanizëm të përshtatshëm për parandalimin e sjelljeve dhe veprimeve delikuente të të miturve, pa qenë e nevojshme zbatimi i masave shtrënguese ose formave të tjera të presionit.

Rëndësia e këtyre masave lidhet kryesisht me mundësinë që ato i ofrojnë të miturit për të vazhduar procesin e edukimit, riedukimit dhe përmirësimit të sjelljes pa u larguar nga jeta në liri. Gjatë kësaj periudhe, i mituri mbetet në mjedisin e tij familjar ose në një mjedis tjetër të përshtatshëm, ku vazhdon procesin e edukimit dhe zhvillimit. Pikërisht qëndrimi në një ambient të tillë krijon kushte më të favorshme për rehabilitimin, riedukimin dhe përmirësimin e sjelljes së tij.[1]

"Brenda sistemit të masave edukative, masat e mbikëqyrjes së shtuar zënë një vend të rëndësishëm për shkak të përdorimit të shpeshtë të tyre në praktikën gjyqësore. Karakteri edukativ, përmbajtja dhe mënyra e zbatimit i bëjnë këto masa veçanërisht të përshtatshme për arritjen e objektivave të politikës penale ndaj të miturve. Nëpërmjet tyre synohet parandalimi i kriminalitetit të të miturve dhe korrigjimi i sjelljes së tyre, pa qenë e nevojshme privimi i të miturit nga liria".

Ky koncept është paraparë shprehimisht edhe në nenin 23, paragrafi 3 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ku përcaktohet se masat e mbikëqyrjes së shtuar shqiptohen ndaj të miturit në rastet

[1] Ragip Halili, *Penologjia* (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2005), fq. 260.

kur mbrojtja e interesit të tij nuk kërkon largimin nga mjedisi ku ai jeton. Përmes këtyre masave i mituri ka mundësi të vazhdojë procesin e edukimit, rehabilitimit dhe trajtimit në mjedisin e tij të zakonshëm, duke iu nënshtruar mbikëqyrjes së përcaktuar me vendim të gjykatës.

Masat e mbikëqyrjes së shtuar kanë karakter edukativ dhe janë masa jashtëinstitucionale. Zbatimi i tyre nuk nënkupton izolimin e të miturit, por ushtrimin e një mbikëqyrje të vazhdueshme nga subjektet e autorizuara, të cilat caktohen me vendim gjyqësor dhe kanë detyrimin të kujdesen për zbatimin e masës dhe për mbështetjen e procesit të rehabilitimit të të miturit.

"Kohëzgjatja e masave edukative të mbikëqyrjes së shtuar nuk mund të jetë më e shkurtër se tre muaj dhe as më e gjatë se dy vjet".

Duke qenë se këto masat zbatohen në liri, ato njihen edhe si masa edukative jashtëinstitucionale. Ato shqiptohen në situatat kur interesi më i mirë i të miturit nuk kërkon ndarjen e tij nga mjedisi familjar ose mjedisi ku ai jeton. Gjykata vendos për shqiptimin e tyre ndaj të miturit delikuent kur vlerëson se është e nevojshme të ndikohet në korrigjimin e sjelljes së tij përmes masave edukative me kohëzgjatje të caktuar, duke synuar edukimin, rehabilitimin dhe trajtimin e tij në mjedisin e zakonshëm shoqëror.[2]

2. Llojet e masave të mbikëqyrjes së shtuar

"Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ndaj të miturve që kanë kryer vepra penale mund të shqiptohen tri forma të mbikëqyrjes së shtuar:

1. Mbikëqyrja e shtuar nga prindi, prindi adoptues, ose kujdestari;
2. Mbikëqyrja e shtuar nga një familje tjetër;
3. Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë."[3]

Masën e mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari, gjykata e shqipton vetëm kur plotësohen dy kushte dhe atë: Së pari, duhet të konstatohet se vepra penale është kryer si pasojë e mungesës së mbikëqyrjes dhe edukimit të duhur nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit. Së dyti, gjykata duhet të bindet se këta persona kanë aftësinë dhe mundësinë për të ushtruar mbikëqyrjen dhe për të ndikuar në edukimin e të miturit.[4]

[2] Ismet Salihu, *E drejta penale për të mitur* (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, 2018), fq. 74.
[3] Halili., vep. e cit., fq. 260.
[4] Salihu, *vep. e cit.*, fq. 76.

Me rastin e shqiptimit të kësaj mase, gjykata mund t'u japë prindit, prindit adoptues ose kujdestarit udhëzime dhe detyrime konkrete për mënyrën e ushtrimit të mbikëqyrjes, ndërsa Shërbimi Sprovues ngarkohet me monitorimin e zbatimit të saj.

"**Mbikëqyrja e shtuar nga një familje tjetër,** zbatohet në rastet kur familja e të miturit nuk ofron kushte të përshtatshme për ushtrimin e mbikëqyrjes nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari. Kjo masë shqiptohet kur këta persona, për shkak të paaftësisë fizike ose psikike, sëmundjeve, varësisë nga alkooli, substancat narkotike apo rrethanave të tjera të ngjashme, që e pengojnë ushtrimin e duhur të mbikëqyrjes dhe kontrollit ndaj të miturit. Familja në të cilën vendoset i mituri duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara me ligj dhe të jap pëlqimin për marrjen e kësaj përgjegjësie. Me propozimin e Shërbimit Sprovues, gjykata përcakton familjen ku do të vendoset i mituri, duke i dhënë përparësi familjarëve ose personave me të cilët ai ka lidhje të afërta emocionale."[5]

"Shqiptimi i kësaj mase bëhet nga Gjykata pasi të dëgjohet prindi, prindit adoptues, ose kujdestarit në rastet kur konstatohet se këta persona nuk janë në gjendje të ushtrojnë mbikëqyrjen e nevojshme ndaj të miturit dhe kur një masë e tillë konsiderohet në interes të tij."

Zbatimi i kësaj mase mund të përfundojë atëherë kur prindi, prindi adoptues ose kujdestari rikthehet në gjendje për të ushtruar mbikëqyrje ndaj të miturit. Po ashtu, masa mund të pushojë së zbatuari kur bazuar në rezultatet e procesit të rehabilitimit, nuk ekziston më nevoja për mbikëqyrje të shtuar.kur Ekzekutimi i kësaj mase përfundon kur prindi, prindi adoptues apo kujdestari i të miturit është në gjendje të ushtrojë mbikëqyrjen e të miturit ndaj tij apo kur sipas rezultateve të rehabilitimit nevoja për mbikëqyrje të shtuar pushon.

"Në rastin e shqiptimit të kësaj mase, gjykata ngarkon Shërbimin Sprovues me detyrën për të kontrolluar mënyrën e ekzekutimit të saj, ndërsa familjes që merr përsipër mbikëqyrjen duhet t'i sigurohet ndihma e nevojshme për realizimin e kësaj përgjegjësie."[6]

Sa i përket kohëzgjatjes së kësaj mase, Kodi i Drejtësisë për të Mitur nuk përcakton një afat të caktuar. Zbatimi i saj përfundon në momentin kur pushojnë shkaqet që kanë pamundësuar prindin, prindin adoptues ose kujdestarin të ushtrojnë mbikëqyrjen ndaj të miturit.

[5] Halili, *vep. e cit.*, fq. 264.
[6] Republika e Kosovës, *Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur*, neni 26, par.1, 2 dhe 3.

Një masë tjetër edukative në kuadër të mbikëqyrjes së shtuar është **mbikëqyrja nga organi i kujdestarisë**. Kjo masë shqiptohet nga gjykata pasi të jenë përmbushur dy kushte: së pari, gjykata duhet të ketë dëgjuar prindin, prindin adoptues ose kujdestarin, dhe së dyti, të krijojë bindjen se ata nuk janë në gjendje ta ushtrojnë mbikëqyrjen në mënyrë efektive. Edhe gjatë zbatimit të kësaj mase, i mituri vazhdon të jetojë me prindërit e tij, ndërsa organi i kujdestarisë cakton zyrtarin përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e saj.

Organi i kujdestarisë harton një plan pune për realizimin e kësaj mase, në të cilin përcaktohen detyrimet dhe përgjegjësitë si për të miturin, ashtu edhe për organin përgjegjës. Zyrtari i caktuar është i obliguar të mbajë kontakte të vazhdueshme me të miturin, duke organizuar biseda, vizita dhe forma tjera të përshtatshme mbikëqyrjeje, me qëllim mbështetjen e procesit të edukimit, rehabilitimit dhe riintegrimit të tij.[7]

3. Karakteristikat e masave të mbikëqyrjes së shtuar

"Masat e mbikëqyrjes së shtuar paraqesin një nga masat e rëndësishme në kuadër të drejtësisë për të mitur, duke shërbyer si alternativë ndaj shqiptimit të dënimit me burgim."

"Këto masa janë të përcaktuara me Kodin e Drejtësisë për të Mitur të Republikës së Kosovës, dhe kanë për qëllim mbështetjen e procesit të rehabilitimit, risocializimit dhe zhvillimit të përshtatshëm të të miturit. Në kuadër të zbatimit të tyre, rëndësi i kushtohet ofrimit të mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes, si dhe vazhdimit të edukimit dhe aftësimit profesional. Njëkohësisht, përmes këtyre masave synohet zhvillimi i ndjenjës së përgjegjësisë personale te i mituri dhe zvogëlimi i rrezikut të përsëritjes së sjelljeve delikuente."[8]

"Një ndër veçoritë kryesore të këtyre masave është individualizimi i tyre. Gjykata, në bashkëpunim me Shërbimin Sprovues dhe institucionet e tjera kompetente, përcakton masën më të përshtatshme duke marrë parasysh karakteristikat personale të të miturit, rrethanat familjare, mjedisin social dhe nevojat e tij të veçanta. Në këtë mënyrë sigurohet që masa e shqiptuar të mos jetë standarde në çdo rast, por të jetë e përshtatur me qëllimin e rehabilitimit dhe riintegrimit të suksesshëm."[9]

---

[7] Azem Hajdari, *Sistemi i drejtësisë për të mitur – Komentar* (Prishtinë, 2010), fq. 65.
[8] Republika e Kosovës, *Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur*, neni 22.
[9] Ragip Halili, *Kriminologjia* (Prishtinë, 2014), fq. 211.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i masave të mbikëqyrjes së shtuar është orientimi drejt riintegrimit shoqëror. Përveç shmangies së përsëritjes së veprave penale, këto masa synojnë që i mituri të fitojë aftësi dhe shprehi që i mundësojnë një jetë të rregullt në përputhje me normat shoqërore, si dhe të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë personale. Kjo qasje është në përputhje me standardet ndërkombëtare për drejtësinë për të mitur, përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Rregullat e Pekinit, të cilat kërkojnë që interesat më të mira të fëmijës të jenë në qendër të çdo procedure.[10]

Përveç këtyre karakteristikave të përgjithshme, masat e mbikëqyrjes së shtuar dallohen edhe për disa elemente të veçanta. Ato mbështeten në parimin e proporcionalitetit, që nënkupton se gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat e kryerjes së saj dhe shkallën e përgjegjësisë së të miturit, në mënyrë që masa të jetë e drejtë dhe e arsyeshme. Kjo ka rëndësi të veçantë, pasi sjellja e të miturit shpesh ndikohet nga mosha, zhvillimi emocional dhe rrethanat sociale ku ai jeton.[11]

"Së fundi, duhet theksuar se masat e mbikëqyrjes së shtuar në Kosovë ende përballen me sfida praktike, si mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare në shërbimin sprovues, mungesa e programeve të specializuara për të miturit dhe vështirësia për të siguruar bashkëpunimin e prindërve në disa raste. Megjithatë, përkundër këtyre pengesave, ky sistem mbetet një ndër mekanizmat më të rëndësishëm për ndërtimin e një drejtësie më humane dhe efikase për fëmijët në konflikt me ligjin."[12]

4. Kushtet për shqiptimin e masave të mbikëqyrjes së shtuar

Masat e mbikëqyrjes së shtuar paraqesin një nga mekanizmat më të rëndësishëm të sistemit të drejtësië penale në Republikën e Kosovës, përmes të cilave synohet realizimi i qëllimeve të reagimit penal ndaj të miturve pa iu drejtuar privimit të lirisë. Këto masa kanë karakter alternativ dhe mundësojnë që i mituri të vazhdojë të jetojë në mjedisin familjar, duke qenë nën mbikëqyrjen e organeve kompetente. Në këtë mënyrë krijohen kushte për vazhdimin e edukimit, rehabilitimit dhe riintegrimit të të miturit në shoqëri. Për shqiptimin e tyre, legjislacioni përkatës ka përcaktuar

[10] Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 3; Rregullat e Pekinit, rregulla 24.1.
[11] Ismet Elezi, Skënder Kaçupi dhe Maksim Haxhia, *E drejta penale* (Tiranë, 2008), fq. 204.
[12] OSBE Mission in Kosovo, *Report on Juvenile Justice and Alternative Measures* (Prishtinë, 2019), 23.

disa kritere dhe kushte të veçanta, të cilat synojnë sigurimin e një trajtimi proporcional dhe të përshtatshëm për të miturin.

Një ndër kriteret kryesore për vendosjen e masave të mbikëqyrjes së shtuar është analiza individuale e gjendjes dhe karakteristikave të të miturit, duke përfshirë personalitetin e tij, rrethanat familjare, kushtet sociale dhe gjendjen ekonomike. Gjykata duhet të vlerësojë nëse aplikimi i kësaj mase është i përshtatshëm në rastin konkret, nëse nuk paraqet rrezik për sigurinë publike dhe nëse ekzistojnë mundësi reale për zbatimin dhe mbikëqyrjen e masës së shqiptuar. Sipas qëndrimeve të doktrinës juridike në Kosovë, vlerësimi psikosocial i të miturit paraqet një element të domosdoshëm për përcaktimin e masës së duhur, pasi siguron që mbikëqyrja e shtuar të mos përdoret vetëm si formë ndëshkimi, por si një instrument edukimi, rehabilitimi dhe mbështetje sociale për të miturin.[13]

"Kriteret e përgjithshme për shqiptimin e masave të mbikëqyrjes së shtuar janë:

1. Nevoja e të miturit që t'i tërhiqet vërejtja me anë të masës edukative me të cilën i tregohet, i bëhet me dije se me sjelljen e tij e ka kryer një vepër të dëmshme e cila me ligj është paraparë si vepër penale;
2. Nevoja e të miturit për edukim, riedukim dhe zhvillimin e tij të drejtë, qëllim ky që mund të realizohet në mjedisin e mëparshëm të miturit. Për shqiptimin e këtyre masave gjykata duhet të konstatojë se nuk është e nevojshme që i mituri të ndahet, të izolohet nga mjedisi i tij familjar dhe social;
3. Nevoja e të miturit që sjelljet e tij, të cilat kanë çuar në kryerjen e veprës penale, të përmirësohen me anë të programit afatshkurtër apo afatgjatë;
4. Nevoja e të miturit që me anë të këtyre masave t'i mundësohet arsimimi dhe aftësimi profesional."[14]

5. Autoriteti që i shqipton masat e mbikëqyrjes së shtuar

"Në procedurat gjyqësore që kanë të bëjnë me të miturit, institucionet dhe personat kompetent kanë detyrim që të veprojnë në mënyrë të shpejtë dhe pa vonesa të panevojshme. Ky

[13] Ismet Salihu, Hilmi Zhitia dhe Fejzullah Hasani, *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës* (Prishtinë, 2014), fq. 214.
[14] Salihu, *vep. e cit.*, fq. 75.

detyrim vlen edhe për subjektet nga të cilat kërkohen informacione, raporte ose mendime gjatë procedurës."

Një element i veçantë i drejtësisë për të mitur lidhet me moshën e përsonit në momentin e kryerjes së veprës penale.Për fëmijët nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjeçare nuk zhvillohet procedurë gjyqësore. Nëse konstatohet se personi ka qenë nën këtë moshë në kohën e kryerjes së veprës penale, procedura e filluar pushohet dhe për rastin njoftohet nga organi i kujdestarisë. Gjatë çdo veprimi procedural ku është i pranishëm i mituri, veçanërisht gjatë marrjes në pyetje, organet kompetente duhet të tregojnë kujdes të veçantë dhe të marrin parasysh zhvillimin psikologjik dhe karakteristikat personale të tij, në mënyrë që procedura të mos ndikojë negativisht në zhvillimin e mëtejshëm të të miturit.[15]

"I mituri duhet të ketë mbrojtës në rastet e mbrojtjes së detyrueshme si vijon:

1. Prej marrjes së parë në pyetje;
2. Prej aktvendimit për fillimin e procedurës përgatitore, nëse procedura përgatitore zhvillohet për vepër penale të dënueshme me burgim prej më shumë se tri vjet;
3. Prej aktvendimit për fillimin e procedurës përgatitore për veprat e tjera penale për të cilat parashihet dënim më i butë, nëse gjyqtari për të mitur konsideron se i mituri ka nevojë për mbrojtës;
4. Në rast të mbrojtjes së detyrueshme, nëse i mituri mbetet pa mbrojtës gjatë rrjedhës së procedurës dhe nëse ai nuk mund të sigurojë tjetër mbrojtës, gjyqtari për të mitur ose organi kompetent që e zbaton procedurën emëron një mbrojtës të ri sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike;
5. Të miturin mund ta përfaqësojë vetëm mbrojtësi i regjistruar në Odën e Avokatëve."

Prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari kanë të drejtë të jenë të pranishëm dhe ta shoqërojnë të miturin gjatë procedurës penale, ndërsa pjesëmarrja e tyre mund të kërkohet edhe nga gjykata kur kjo vlerësohet në interesin më të mirë të miturit. Kur prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari i të miturit nuk e kryejnë detyrën e tyre prindërore, gjykata mund të caktojë një kujdestar të përkohshëm për të miturin.

[15] Azem Hajdari, "*E drejta e procedurës penale e të miturve"* (me Ligjin Penal për të Mitur)" (Prishtinë, 2005), fq. 202.

Në rastet kur i mituri dyshohet se ka kryer veprën penale së bashku me një person madhor, procedura penale ndaj tij, si rregull, zhvillohet veçmas dhe në përputhje me dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Megjithatë, procedura mund të zhvillohet së bashku me atë ndaj të rriturit vetëm nëse një bashkim i tillë konsiderohet i domosdoshëm për zbardhjen e plotë të rrethanave të çështjes. Vendimin për bashkimin ose ndarjen e procedurës e merr trupi gjykues për të mitur i gjykatës kompetente, duke u bazuar në një propozim të arsyetuar të prokurorit të shtetit ose mbrojtësit.

Edhe kur procedura penale zhvillohet në mënyrë të përbashkët ndaj të miturit dhe një person madhor, ndaj të miturit vazhdojnë të zbatohen dispozitat e posaçme të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, të cilat kanë për qëllim garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tij. Dispozitat e tjera procedurale mund të aplikohen vetëm nëse ato janë në pajtim me rregullat që përcaktojnë zhvillimin e procedurës së përbashkët.

Me qëllim të sigurimit të një trajtimi të specializuar të rasteve që përfshijnë të miturit, organi kompetent për çështjet gjyqësore mund të përcaktojë një gjykatë që ushtron kompetencën e shkallës së parë për shqyrtimin e çështjeve penale ndaj të miturve në territorin e disa gjykatave. Në gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, trupi gjykues për të mitur përbëhet nga një gjyqtar për të mitur dhe dy gjyqtarë laik. Në shkallën e tretë, kolegji për të mitur përbëhet nga tre gjyqtarë, prej të cilëve së paku një duhet të jetë gjyqtarë për të mitur. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues përbëhet nga dy gjyqtarë për të mitur dhe tre gjyqtarë laik.

Sa i përket kompetencës terrioriale, rregulli i përgjithshëm është që procedura penale ndaj të miturit mund të zhvillohet në gjykatën e territorit ku ai ka vendbanimin e përhershëm. Në rastet kur vendbanimi i përhershëm nuk ekziston ose nuk mund të përcaktohet, kompetente konsiderohet gjykata e territorit ku i mituri ka vendbanimin aktual. Përveç këtyre rasteve, procedura mund të zhvillohet edhe në gjykatën ku i mituri ndodhet në atë kohë ose në gjykatën e territorit ku është kryer vepra penale, kur një zgjidhje e tillë vlerësohet më e përshtatshme dhe mundëson zhvillimin më efikas të procedurës.[16]

[16] Hajdari, *vep. e cit.*, 204–205.

6. Procedura e shqiptimit të masave të mbikëqyrjes së shtuar

"Masat e mbikëqyrjes së shtuar si një nga format kryesore të masave edukative që gjykata mund të shqiptojë ndaj të miturve kanë për qëllim riintegrimin social të të miturit përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe ndihmës institucionale, duke shmangur masat më të ashpra si: dërgimi në institucion edukativo-korrektues apo dënimi me burgim."

6.1. Fillimi i procedurës

"Procedura për shqiptimin e masave të mbikëqyrjes së shtuar fillimisht zhvillohet në kuadër të procesit penal ndaj të miturve përgjatë zhvillimit të hetimeve. Prokurori i shtetit pasi vlerëson provat dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, mund të propozojë që ndaj të miturit të shqiptohet një masë edukative e mbikëqyrjes së shtuar, në vend të ushtrimit të ndjekjes së plotë penale. Vendimin për këtë propozim e merr Departamenti për të Mitur i Gjykatës Themelore kompetente, e cila shqyrton në seancë dëgjimore."

Gjatë procedurës vendimmarrëse, gjykata është e detyruar të ketë parasysh:

a. Moshën dhe nivelin e pjekurisë së të miturit;
b. Rrethanat familjare, sociale dhe psikologjike;
c. Qëndrimin e të miturit ndaj veprës; dhe
d. Rekomandimet e shërbimit sprovues."[17]

"Kjo do të thotë se gjykata kur konstaton se qëllimet edukative mund të arrihen pa izolim, ajo mund të shqiptojë një masë të mbikëqyrjes së shtuar që përfshinë një ose disa detyrime, nëse gjykata konstaton se është e domosdoshme për ekzekutimin e suksesshëm të masës, me kusht që detyrimet e veçanta të mos e tejkalojnë afatin e masës. Gjykata ndaj të miturit mund të shqiptojë këto detyrime të veqanta:

- personalisht t'i kërkojë falje palës së dëmtuar;

- palës së dëmtuar t'ia kompensojë dëmin në pajtim me gjendjen financiare të të miturit;

- të vijojë rregullisht shkollimin;

[17] Ismet Salihu, *E drejta penale – pjesa e përgjithshme* (Prishtinë, 2020), fq. 412.

- të pranojë punësimin ose të aftësohet për një profesion i cili i përshtatet aftësive dhe shkathtësive të tij;

- të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;

- të pranojë këshilla psikologjike;

- të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri;

- të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe alkoolit."[18]

7. Kohëzgjatja e masave të mbikëqyrjes së shtuar

"Masat edukative të mbikëqyrjes së shtuar shqiptohen për një periudhë të caktuar kohore me synim edukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturit në shoqëri. Kohëzgjatja e tyre përcaktohet nga gjykata, e cila gjatë vendimmarrjes merr në konsideratë personalitetin e të miturit, rrethanat familjare, nivelin e zhvillimit të tij, si dhe nevojën për mbikëqyrje dhe përkrahje edukative."

Në përputhje me dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe qëndrimet e literaturës juridike, masat e mbikëqyrjes së shtuar nuk mund të zgjasin më pak se tre muaj dhe as më shumë se dy vjet. Gjatë kësaj periudhe, gjykata ndjek zbatimin e masës përmes raporteve dhe mbikëqyrjes që ushtrohen nga Shërbimi Sprovues i Kosovës dhe sipas rastit nga organi i kujdestarisë.[19]

Ekzekutimi i masave të mbikëqyrjes së shtuar realizohet nga subjekti të cilit gjykata ia ka besuar zbatimin e masës, duke pasur gjithmonë për qëllim edukimin, rehabilitimin, dhe riintegrimin e të miturit në shoqëri. Kur masa zbatohet në familjen tjetër, i mituri vendoset në një mjedis familjar që ofron kushte më të përshtatshme për zhvillimin dhe edukimin e tij. Ndërkaq, kur masa ekzekutohet nga organi i kujdestarisë, ky organ cakton personin përgjegjës për mbikëqyrjen e të miturit dhe harton një plan pune që përfshin aktivitetet dhe masat e nevojshme për edukimin, mbështetjen dhe rehabilitimin e tij. Personi përgjegjës mban kontakte të rregullta me të miturin, organizon biseda, vizita dhe forma të tjera të mbikëqyrjes, ndërsa organi i kujdestarisë monitoron vazhdimisht zbatimin e masës dhe bashkëpunon me gjykatën, familjen dhe

[18] Republika e Kosovës, *Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur*, neni 28.
[19] Po aty, neni 23, par.3.

institucionet e tjera përkatëse. Në të gjitha rastet, ekzekutimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar synon të ndikojë pozitivisht në sjelljen e të miturit, duke shmangur izolimin e tij nga mjedisi shoqëror dhe duke favorizuar zhvillimin e përgjegjësisë dhe integrimin e tij në komunitet.[20]

8. Zëvendësimi i masave të mbikëqyrjes së shtuar

Vendimi për zëvendësimin e masës edukative merret nga gjykata kompetente, pasi ajo shqyrton dhe vlerëson raportet e hartuara nga institucionet dhe profesionistët pergjegjës për mbikëqyrjen e të miturit, përfshirë mbikëqyrësin, punëtorin social dhe psikologun.

Nëse gjatë ekzekutimit të masës ndryshojnë rrethanat që kanë qenë bazë për shqiptimin e saj, gjykata mund të vendosë për ndryshimin, ndërprerjen ose zëvendësimin e saj më një masë tjetër edukative, duke marrë parasysh interesin më të mirë të të miturit. Në këtë proces, gjykata vlerëson rrethanat konkrete të të miturit dhe nevojën që masa e shqiptuar t'i përshtatet zhvillimit dhe nevojave të tij.[21]

Zëvendësimi i masës paraqet një mundësi për përshtatjen e masës edukative me ndryshimet në gjendjen personale, familjare, sociale dhe edukative të të miturit. Në këtë mënyrë, masa mund të vazhdojë të përmbushë qëllimin e saj edukativ, rehabilitues dhe riintegrues.

9. Pushimi i masave të mbikëqyrjes së shtuar

Pushimi i masës paraqet mundësinë e ndërprerjes së ekzekutimit të saj kur pas rishqyrtimit të rrethanave të rastit, vlerësohet se masa nuk duhet të vazhdojë të ekzekutohet. Gjykata, gjatë rishqyrtimit merr parasysh rrethanat e reja, faktet ose provat që mund të ndikojnë në përcaktimin e masës edukative dhe nevojat konkrete të të miturit.

Sipas nenit 94, par.2., të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, kur ekzekutimi i masës edukative nuk fillon brenda një viti nga dita kur vendimi ka marrë formën e prerë, gjykata duhet ta rishqyrtojë vendimin. Pas këtij vlerësimi, gjykata mund të vendosë që masa të vazhdojë të ekzekutohet ose të ndërpritet, ndërsa në rrethanat e përshtatshme mund të zëvendësohet me një masë tjetër edukative. Në këtë mënyrë, ligji mundëson që masa të përshtatet me rrethanat dhe nevojat e të miturit.[22]

[20] Halili., vep. e cit., fq. 241-242.
[21] Republika e Kosovës, *Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur*, neni 94.
[22] Po aty, neni 94, paragrafi. 2.

Kjo dispozitë ligjore dëshmon se masat edukative nuk janë masa të pandryshueshme, por mund të përshtaten në përputhje me ndryshimet në gjendjen personale, familjare, sociale dhe edukative të të miturit, si dhe me rezultatet e arritura gjatë zbatimit të tyre. Në të njejtën kohë, ligji vendos kufizime për mbrojtjen e të miturit, duke mos lejuar shqiptimin e një mase më të rëndë edukative vetëm si pasojë e rishqyrtimit të bazuar në prova të reja, me qëllim ruajtjen e sigurisë juridike dhe pozitës së tij ligjore.

10. Roli i Shërbimit Sprovues dhe Qendrës për Punë sociale në ndërlidhje me masat e mbikëqyrjes së shtuar

Shërbimi Sprovues dhe Qendra për punë Sociale kanë rol të rëndësishëm në ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve. Këto institucione bashkëpunojnë me gjykatën, familjen dhe institucionet e tjera për të siguruar edukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm të miturit në shoqëri.

Shërbimi sprovues ka për detyrë të mbikëqyrë zbatimin e masave të shqiptuara nga gjykata, të përcjellë sjelljen e të miturit dhe të raportojë lidhur me progresin e tij. Gjithashtu, ai ofron ndihmë profesionale për familjen dhe personat që ushtrojnë mbikëqyrjen ndaj të miturit, me qëllim që masa edukative të realizojë efektet e saj.

Ndërkaq, Qendra për Punë Sociale, përmes organit të kujdestarisë, merr pjesë në procesin e ekzekutimit të masave të mbikëqyrjes së shtuar, duke bashkëpunuar me prindërit, shkollën, institucionet sociale dhe organet e drejtësisë. Ajo ndihmon në identifikimin e nevojave sociale dhe edukative të të miturit, ofron mbështetje profesionale dhe ndërmerr veprime për mbrojtjen e interesit më të mirë të tij.

Bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Sprovues dhe Qendrës për punë Sociale është i domosdoshëm për realizimin e qëllimit të masave të mbikëqyrjes së shtuar, i cili konsiston në edukimin, rehabilitimin dhe parandalimin e përsëritjes së sjelljeve delikuente nga ana e të miturit.[23]

[23] Salihu, *vep. e cit.*, fq. 80.

Kapitulli II

VËSHTRIMI HISTORIK DHE KRAHASUES I MASAVE TË MBIKËQYRJES SË SHTUAR NDAJ TË MITURVE

1. Një historik i shkurtër i masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve në përgjithësi

Përkundër faktit se në krahasim me kryerësit madhor të veprave penale, në të shumtën e rasteve veprat penale të kryera nga të miturit janë më të lehta, mirëpo ka raste kur të miturit kryejnë edhe vepra penale shumë të rënda. Në të drejtat penale bashkëkohore, për shumë shkaqe, trajtimi i kryerësve të mitur të veprave penale është shumë më i butë se ndaj kryerësve madhorë të veprave penale nga fakti se personat e mitur ende gjenden në fazën e zhvillimit dhe të formësimit të tyre biopsikik dhe si të tillë nuk janë në gjendje që plotësisht të kuptojnë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojnë sjelljet e tyre. Gjithashtu, në shkencën e së drejtës penale është konstatuar se një ndër shkaktarët kryesor të kriminalitetit të miturve është kujdesi jo i duhur i familjes dhe ndikimit negativ të mjedisit dhe në përgjithësi të shoqërisë.

Edhe në të kaluarën, për shkak se personat e mitur akoma nuk e kanë arritur pjekurinë e duhur biopsikike, gjatë tërë historisë së njerëzimit kjo kategori e kryerësve të veprave penale ka pasur trajtim të posaçëm dhe në krahasim me personat madhorë ka pasur trajtim më të butë, madje edhe më të privilegjuar në të drejtën penale. Kësisoj edhe në të drejtën romake fëmijët deri në moshën shtatëvjeçare janë konsideruar penalisht të papërgjegjshëm për shkak të mungesës së zhvillimit adekuat të tyre psikik dhe paaftësisë që të kuptojnë rëndësinë morale dhe shoqërore të veprës penale.

"Sipas të drejtës romake, personat prej moshës dhjetë (10) vjeçare deri në katërmbëdhjetë (14) vjeçare në të drejtën romake janë konsideruar penalisht të përgjegjshëm. Gjithashtu, si rrethanë lehtësuese është konsideruar edhe mosha e kryerësit prej katërmbëdhjetë (14) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, e në disa raste edhe deri njëzetepesë (25) vjeçare. Në të drejtën e mesjetës, nuk kanë ekzistuar dispozita të posaçme juridike për kryerësit e mitur të veprave penale, mirëpo tortura ndaj tyre është zbatuar në përmasa më të pakta."[24]

[24] Vlado Kambovski, *E drejta penale* (Shkup, 2004), fq. 32.

"Pozita e kryerësve të mitur të veprave penale dukshëm është përmirësuar me kodifikimet që u bënë në të drejtën penale në gjysmën e dytë të shekullit XVIII dhe në shekullin XIX. Nën ndikimin e ideve të Cezaro Bekarios u caktua mosha më e ulët dhe më e lartë e të miturve ndaj të cilëve mund të shqiptohen sanksionet e caktuara penale. Kësisoj, Kodi Penal i Leopald Toskanes (1786) në dispozitat e tij, ndër të parët përcaktoi kritere të reja për konstatimin e përgjegjësisë penale të të miturve."

"Sipas këtij Kodi Penal, ndaj fëmijës gjer në moshën 12-vjeçare nuk ka mund të shqiptohet kurrfarë dënimi, ndaj tij ka mund të shqiptohet vetëm masa edukuese. Ndaj të miturve në moshën prej 12 deri 14 vjeç kanë mundur të shqiptohen dënime nëse kanë qenë penalisht të përgjegjshëm, ndërsa të miturit prej moshës 14 gjer 18 vjeç janë konisderuar penalisht të përgjegjshëm dhe janë dënuar, mirëpo janë dënuar më lehtë në krahasim me kryerësit madhorë të veprave penale."[25]

Në fillim të shekullit XX, si rezultat i ndikimit të teorive të shkollës sociologjike, në fushën e të drejtës penale filluan të zbatohen gjithnjë e më shumë masa të veçanta për kryerësit e mitur të veprave penale. Në këtë periudhë, si persona madhorë konsiderohen kryesisht ata që kishin arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Gjatë viteve tridhjetë të shekullit XX, në shumicën e sistemeve juridike penale evropiane u parashikuan masat edukative si forma të veçanta të sanksioneve penale të dedikuara për të miturit.

Pas vendosjes së masave edukative si kategori e veçantë e sanksioneve penale për të miturit, u krijuan edhe institucione të specializuara gjyqësore për trajtimin e tyre, përkatësisht gjykatat për të miturit.[26]

2. Një historik i shkurtër i masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve në Kosovë

Zhvillimi i së drejtës penale për të mitur në Kosovë ka kaluar nëpër disa etapa të rëndësishme. Gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë, trajtimi juridiko-penal i të miturve rregullohej me Kodin Penal të vitit 1929, i cili bënte dallimin ndërmjet të miturve dhe të rriturve, duke i dhënë përparësi masave edukative si forma kryesore të reagimit ndaj delikuencës së të miturve. Më vonë, me miratimin e Kodit Penal të vitit 1951 dhe ndryshimeve të vitit 1959, sistemi u zhvillua më tej duke forcuar rolin e masave edukative dhe duke kufizuar përdorimin e dënimeve ndaj të miturve.

[25] Po aty, fq. 1023.
[26] Kambovski, *vep. e cit.*, fq. 1025.

Një fazë tjetër e rëndësishme u shënua pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1974, kur Kosova fitoi kompetenca më të gjera në fushën e legjislacionit penal. Në këtë periudhë, Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977 rregulloi në mënyrë më të detajuar pozitën juridike të të miturve, kushtet për shqiptimin e masave edukative dhe llojet e sanksioneve që mund të aplikoheshin ndaj tyre.

Pas vitit 1999, sistemi i drejtësisë për të mitur në Kosovë iu nënshtrua një procesi të harmonizimit me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Si rezultat i këtij procesi, u krijuan dispozita të posaçme që e vendosën në qendër rehabilitimin, edukimin dhe riintegrimin shoqëror të të miturve, duke e orientuar sistemin drejt mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës.[27]

3. Vështrimi krahasues i masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve

"Pas çlirimit të Kosovës më 12 qershor 1999 u paraqit nevoja për ndërtimin e një legjislacioni të ri, i cili do të ishte në përputhje me standardet e vendeve të Evropës Perëndimore. Për shkak të nevojës për forcimin e sundimit të ligjit dhe luftimin më efikas të kriminalitetit, administrata e UNMIK-ut filloi hartimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale si pjesë e reformës së sistemit juridik."

"Gjatë viteve 2000-2001, një grup ekspertësh nga UNICEF-i, OSBE-ja dhe ekspertë vendorë hartuan draftin e parë të Ligjit Penal për të Mitur. Më pas, nga fundi i vitit 2001 deri në mesin e vitit 2002, puna vazhdoi nga Këshilli i Përbashkët Këshilldhënës për Çështje legjislative, i përbërë nga ekspertë kosovarë dhe ndërkombëtarë, me pjësmarrjen e përfaqësuesve të Zyrës Ligjore të UNMIK-ut, OSBE-së, Shoqatës së Juristëve Amerikanë dhe Institutit të Gjyqësisë së Kosovës."

Para miratimit, projektligji iu nënshtrua diskutimeve publike, ku morën pjesë gjyqtarë, prokurorë, punonjës socialë, zyrtarë policorë dhe profesionistë të tjerë të fushës së drejtësisë për të mitur. Ligji Penal për të Mitur u miratua më 20 Prill 2004 dhe për shkak të rëndësisë së tij hyri në fuqi po atë ditë. Me këtë atë, për herë të parë në Kosovë, trajtimi juridiko-penal i të miturve u rregullua me një ligj të veçantë, në përputhje me praktikat e vendeve të Evropës Perëndimore.

[27] Salihu, *vep. e cit.*, fq. 36.

Krahasuar me vendet e tjera të rajonit, Kosova ishte ndër të parat që miratoi një ligj të posaçëm për drejtësinë penale për të mitur, duke krijuar një bazë ligjore të veçantë për trajtimin e kësaj kategorie.

"Në krahasim me legjislacionin penal, i cili u aplikuar gjer më 5 prill të vitit 2004, Ligjit Penal për të Mitur, që duke marrë parasysh edhe specifikat shoqërore dhe infrastrukturën e institucioneve tona është kompatibil me shtetet e zhvilluara. Siç do të shohim në vazhdim, prioritet i Ligjit Penal për të Mitur është shqiptimi i masave edukative si masa jopenale ndaj kryerësve të mitur të veprave penale në ekzekutimin e të cilave rol të rëndësishëm ka shërbimi sprovues dhe organi i kujdestarisë në bashkëpunim me prindërit e të miturit, prokurorinë, policinë dhe gjykatën. Koncepti i këtillë i trajtimit të delikuentëve të mitur është në pajtim me trendet bashkëkohore të së drejtës penale dhe kriminologjisë."[28]

3.1. Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve sipas legjislacionit penal të Shqipërisë

"Sistemi i drejtësisë penale për të mitur në Republikën e Shqipërisë është ndërtuar mbi parimet e mbrojtjes, edukimit dhe riintegrimit shoqëror të të miturve, në përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Korniza kryesore ligjore që rregullon këtë materie është Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili parashikon një sërë masash alternative ndaj dënimit me burgim, ndër të cilat një vend të rëndësishëm zënë edhe masat e mbikëqyrjes së shtuar. Këto masa kanë karakter edukativ, rehabilitues dhe parandalues, duke synuar zhvillimin pozitiv të të miturit dhe shmangien e përsëritjes së sjelljeve kundërligjore."[29]

Sipas dispozitave të këtij Kodi, mbikëqyrja e shtuar realizohet duke e vendosur të miturin nën përkujdesjen dhe përgjegjësinë e prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor, si dhe, sipas rastit nën mbikëqyrjen e institucioneve kompetente. Personat ose institucionet përgjegjëse kanë për detyrë të monitorojnë sjelljen e të miturit, vijimin e arsimit dhe përfshirjen e tij në jetën shoqërore, me qëllim që të mbështesin rehabilitimin dhe zhvillimin e tij.

Përveç mbikëqyrjes së vazhdueshme, sistemi shqiptar parashikon edhe përfshirjen e të miturit në programe edukative, trajnime profesionale, aktivitete komunitare dhe këshillim psikologjik. Gjykata kompetente për çështjen e të miturve cakton kohëzgjatjen e masës dhe

[28] Po aty, fq. 38.
[29] Elira Kodra, *Drejtësia penale për të mitur në Shqipëri* (Tiranë, 2019), fq. 53.

mbikëqyr zbatimin e saj në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe Qendrën për Shërbime Sociale, të cilat raportojnë periodikisht për ecurinë e rastit.[30]

Një karakteristikë e rëndësishme e legjislacionit shqiptar është mundësia e përshtatjes së masës në varësi të progresit të miturit. Nëse gjatë ekzekutimit të saj konstatohet përmirësimi i sjelljes dhe angazhim aktiv në procesin edukativ, gjykata mund të vendosë shkurtimin e kohëzgjatjes ose ndërprerjen e parakohshme të masës. Kjo dëshmon orientimin rehabilitues të sistemit, ku prioritet i jepet edukimit dhe riintegrimit, e jo ndëshkimit.

Në praktikë, zbatimi i masave të mbikëqyrjes së shtuar ka dhënë rezultate pozitive në parandalimin e përsëritjes së veprave penale nga të miturit. Kjo lidhet me bashkëpunimin ndërmjet profesionistëve të profileve të ndryshme, si punonjësit social, psikologët dhe edukatorët, të cilët hartojnë dhe zbatojnë plane individuale rehabilitimi për secilin të mitur. Megjithatë, zbatimi i këtyre masave vazhdon të përballet me sfida, si mungesa e kapaciteteve profesionale në disa zona, infrastruktura e pamjaftueshme dhe burimet financiare të kufizuara.

Gjithashtu, legjislacioni shqiptar i kushton rëndësi të veçantë rolit të familjes dhe komunitetit në procesin e rehabilitimit të të miturit. Përfshirja aktive e prindërve, institucioneve arsimore dhe komunitetit konsiderohet një element i domosdoshëm për arritjen e rezultateteve të qëndrueshme në edukimin dhe riintegrimin e të miturve, duke reflektuar praktikat bashkëkohore të sistemeve evropiane të drejtësisë për të mitur.

"Sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur si masa të karakterit mbikëqyrës të të miturve konsiderohen:

1. **Vendosja nën mbikëqyrjen e prindit ose kujdestarit** - Këtu prindi është ai që mban përgjegjësi direkte për edukimin ose sjelljen e të miturit.
2. **Mbikëqyrja nga Shërbimi i Provës** - Në rastin e kësaj mase është Shërbimi i Provës ai që ka detyrë ta bëjë monitorimin e vazhdueshëm institucional dhe bënë raportim periodik te gjykata.
3. **Detyrimi për ndjekjen e programeve edukative ose profesionale** - Në rastin e dhënë mbikëqyrja ka të bëjë me vijimin e shkollimit, ndalim shoqërimin, trajnim pune, këshillimit psikologjik etj.

[30] Artan Muçaj, *Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur* (Tiranë, 2020), fq. 78.

4. **Detyrimi për respektimin e kushteve të sjelljes** - Në këto raste mbikëqyrja bëhet për të përcjellë lëvizjet, kufizime lëvizjeje, ndalim shoqërimin me persona të caktuar, paraqitjen në institucionet përkatëse etj."

Në përfundim, masat e mbikëqyrjes së shtuar përbëjnë një instrument të rëndësishëm të sistemit shqiptar të drejtësisë për të mitur, pasi synojnë rehabilitimin, edukimin dhe riintegrimin shoqëror të të miturve, duke vendosur në qendër interesin e tyre më të mirë.[31]

3.2. Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve sipas legjislacionit penal të Kroacisë

Sistemi i drejtësisë penale për të mitur në Republikën e Kroacisë konsiderohet ndër më të zhvilluarit në rajon, duke u mbështetur në parimet e edukimit, rehabilitimit dhe riintegrimit shoqëror të të miturve. Legjislacioni kroat parashikon një sistem të veçantë të masave edukative, në të cilin masat e mbikëqyrjes së shtuar zënë vend të rëndësishëm. Qëllimi kryesor i tyre është korrigjimi i sjelljes së të miturit dhe parandalimi i përsëritjes së veprave penale, duke shmangur sa herë që është e mundur zbatimin e masave që përfshijnë privimin e lirisë. [32]

"Sipas legjislacionit kroat, masat e mbikëqyrjes së shtuar zbatohen ndaj të miturve për të cilët vlerësohet se kanë nevojë për kontroll dhe udhëzim të vazhdueshëm, por jo për masa më të rënda penale."

Mbikëqyrja realizohet përmes shërbimeve sociale dhe profesionistëve të specializuar, të cilët monitorojnë sjelljen, arsimimin dhe përfshirjen sociale të të miturit. Gjykata përcakton kohëzgjatjen e masës dhe obligimet konkrete që i mituri duhet t'i respektojë, si ndjekja e rregullt e shkollës, pjesëmarrja në programe edukative ose këshillimore, si dhe respektimi i rregullave të vendosura nga autoritetet përkatëse.[33]

Një veçori e rëndësishme e sistemit kroat është përfshirja aktive e familjes në procesin e mbikëqyrjes dhe rehabilitimit të të miturit. Legjislacioni kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet prindërve ose kujdestarëve ligjorë dhe institucioneve përgjegjëse, me qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për edukimin dhe zhvillimin e të miturit. Po ashtu, gjykata ka të drejtë

[31] Mimoza Qato, *Zbatimi i masave alternative për të miturit në Shqipëri* (Tiranë, 2021), fq. 65.
[32] Petar Novoselec, *Kazneno pravo za mladež* (Zagreb, 2018), fq. 102.
[33] Željko Horvatić, *Sustav sankcija prema maloljetnicima* (Zagreb, 2019), fq. 67.

të rishikojë periodikisht masën e shqiptuar dhe në varësi të progresit të të miturit, ta ndryshojë, ta zëvendësojë ose ta ndërpresë atë.

"Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve sipas legjislacionit kroat janë:

1. **Mbikëqyrja e shtuar nga shërbimet sociale** - Në rastin konkret është fjala për kontroll profesional nga punonjës social të specializuar.
2. **Mbikëqyrja me detyrim arsimimi ose pune** - Në këtë rast i mituri përcillet nëse po bënë vijim të rregullt në shkollë ose po vijon trajnimin profesional.
3. **Mbikëqyrja me udhëzim dhe këshillim të detyrueshëm** - Në rastin konkret mbikëqyrja bëhet për të përcjellë të miturin nëse po i ndjek programet psikologjike, edukative dhe sociale të cilat është vendosur që t'i ndjek.
4. **Mbikëqyrja me kushte të veçanta sjelljeje** - Në këto raste mbikëqyrja fokusohet në mbikëqyrjen e të miturit nëse po i respekton kufizimet për të cilat është autorizuar mbikëqyrja, kufizimet e kontaktit, lëvizjes ose aktivitetet."[34]

Përvoja praktike në Kroaci tregon se këto masa kanë dhënë rezultate të mira në uljen e recidivizmit dhe në riintegrimin e të miturve në jetën arsimore dhe shoqërore. Bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet gjykatave, shërbimeve sociale dhe institucioneve arsimore ka krijuar një model funksional rehabilitimi, i cili konsiderohet një praktikë e mirë edhe për sistemet e tjera të drejtësisë për të mitur në rajon.

3.3. Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve sipas legjislacionit penal të Italisë

"Sistemi i drejtësisë penale për të mitur në Itali ka një traditë të konsoliduar, e cila mbështetet në parimin se ndaj të miturve duhet të mbizotërojë qasja edukative dh rehabilituese, ndërsa ndëshkimi të përdoret vetëm kur është i domosdoshëm. Baza kryesore ligjore është Dekreti Presidencial nr.448/1988 për Procedurën Penale për të Mitur, i cili rregullon procedurat dhe masat që zbatohen ndaj të miturve në konflikt me ligjin. Ky akt normativ i kushton rëndësi të veçantë personalitetit të të miturit dhe synon që ndërhyrja penale të jetë sa më pak represive dhe sa më shumë e orientuar drejt rehabilitimit."[35]

[34] Lovro Cvitanović, *Odgojne mjere u kaznenom pravu* (Zagreb, 2020), fq. 88.
[35] Alberto Moro, *Procedura penale minorile* (Milano, 2017), fq. 41.

Masat e mbikëqyrjes së shtuar realizohen nëpërmjet mbikëqyrjes dhe udhëzimit të vazhdueshëm nga shërbimet sociale dhe institucionet kompetente. Një nga format më të përdorura është vendosja e të miturit nën mbikëqyrjen e shërbimeve sociale, të cilat kujdesen për zbatimin e programeve edukative, trajtimin psikologjik, pjesëmarrjen në aktivitete komunitare dhe respektimin e detyrimeve të përcaktuara nga gjykata. Gjatë marrjes së vendimit, gjykata merr parasysh rrethanat personale, familjare dhe sociale të të miturit, si dhe nevojën për mbështetje në procesin e rehabilitimit.

"Masat të mbikëqyrjes së të miturit sipas Dekretit Presidencial nr.448/1988 janë:

1. **Vendosja nën mbikëqyrjen e shërbimeve sociale** - Në rastin konkret masa kërkon kontroll të rregullt, rehabilitimin dhe raportimin te gjykata.
2. **Detyrimi për ndjekjen e programeve edukative ose terapeutike** - Këtu është fjala për mbikëqyrje nëse i mituri është duke iu nënshtruar këshillimit psikologjik, programeve kundër varësive të alkoolit dhe drogës, edukimit etj.
3. **Detyrimi për respektimin e kushteve të veçanta** - Këtu është fjala për mbikëqyrje nëse i mituri po i respekton kufizimet e lëvizjes, ndalimit të kontakteve, qëndrimit në ambientin familjar etj.
4. **Kombinimi i masave me rishikim periodik** - Në rastin konkret gjykata mund t'i zbusë, ndryshojë ose ndërpresë masat varësisht nga progresi."[36]

Një karakteristikë e rëndësishme e sistemit italian është rishikimi i vazhdueshëm i masave edukative. Gjykata monitoron zhvillimin e të miturit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të masës dhe nëse konstaton përmirësim të dukshëm në sjellje dhe rehabilitim mund të vendosë zbutjen ose ndërprerjen e saj edhe para përfundimit të afatit të caktuar. Përveç kësaj, legjislacioni italian nxit bashkëpunimin ndërmjet familjes, komunitetit dhe institucioneve përgjegjëse, duke e konsideruar këtë bashkëpunim një faktor të rëndësishëm në parandalimin e recidivizmit.

Masat e mbikëqyrjes së shtuar kanë për qëllim orientimin e të miturit drejt edukimit, zhvillimit personal dhe integrimit në shoqëri. Përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme nga profesionistë të specializuar, sigurohet zbatimi i detyrimeve të vendosura nga gjykata, ndërsa

[36] Tullio Padovani, *Misure educative nel sistema penale minorile* (Milano, 2019), fq. 73.

raportet periodike mundësojnë vlerësimin e progresit dhe marrjen e vendimeve të mëtejshme lidhur me vazhdimin ose ndryshimin e masës.

Në praktikë, modeli italian vlerësohet si një ndër sistemet më efektive në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Përvoja ka treguar se kombinimi i mbikëqyrjes institucionale me mbështetjen edukative, psikologjike dhe sociale ndikon në uljen e recidivizmit dhe krijon mundësi më të mira për riintegrimin e të miturve në shoqëri.[37]

4. Veçoritë e përbashkëta dhe dalluese në vështrim të rregullimit ligjor të masave të mbikëqyrjes së shtuar në Kosovë, Shqipëri, Kroaci dhe Itali

Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve përfaqësojnë një nga instrumentet më të rëndësishme të drejtësisë për të mitur, duke kombinuar kontrollin juridik me mbështetjen sociale dhe edukative. Analiza e sistemit ligjor të katër vendeve: Kosovë, Shqipëri, Kroaci dhe Itali - tregon se pavarësisht kushteve historike dhe dallimeve strukturore, sa i përket masave të mbikëqyrjes ekzistojnë veçori të përbashkëta që formojnë bazën e masave të mbikëqyrjes si dhe dallime të qarta që lidhen me fleksibilitetin e zbatimit dhe përvojën institucionale.

Një nga veçoritë më të dukshme të të gjitha sistemeve është qasja edukative dhe rehabilituese. Në secilin nga këto shtete, ligji përcakton se masat e mbikëqyrjes nuk kanë karakter ndëshkues të thjeshtë, por kanë për qëllim riintegrimin shoqëror të të miturit dhe korrigjimin e sjelljes së tij. Kjo qasje reflekton një filozofi moderne të drejtësisë për të mitur, ku edukimi dhe mbështetja sociale konsiderohen thelbësore për parandalimin e rikthimit në veprimtari devijante.

Për shembull në Kosovë, Shqipëri, masat përfshijnë detyrimin për ndjekjen e shkollës, pjesëmarrjen në programe edukative dhe respektimin e rregullave të sjelljes, ndërsa në Kroaci dhe Itali, këto detyrime janë të integruara me programe psikologjike dhe aktivitete të strukturuara komunitare, duke i dhënë një dimension më të plotë mbikëqyrjes. Një element tjetër i përbashkët është përfshirja aktive e familjes. Të katër legjislacionet kërkojnë bashkëpunimin e prindërve ose kujdestarëve ligjorë, duke e konsideruar atë si një faktor kyç për suksesin e masës. Roli i familjes nuk kufizohet vetëm në monitorim, por përfshin udhëzimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të të miturit.

[37] Gaetano De Leo, *La prevenzione della recidiva minorile* (Bologna, 2020), fq. 92.

Në Itali dhe Kroaci, ky bashkëpunim është më i strukturuar, me udhëzime të detajuara ligjore dhe procedurale që përcaktojnë mënyrën se si prindi ose kujdestari duhet të ndihmojë në zbatimin e masave, ndërsa në Kosovë dhe Shqipëri, përpjekjet për përfshirjen e familjes janë në faza më të hershme, shpesh të kufizuara nga mungesa e trajnimit të specialistëve social dhe kapaciteteve institucionale.

Një nga dallimet më të qarta ndërmjet këtyre sistemeve ligjore është strukturimi dhe fleksibiliteti i masave të mbikëqyrjes. Në Itali dhe Kroaci, ligji parashikon rishikim periodik të masave, ku gjykata ka mundësi t'i ndryshojë, zbusë ose ndërpresë ato në varësi të përparimit të miturit. Kjo qasje siguron që mbikëqyrja të mos jetë një proces statik, por një instrument dinamik i orientuar drejt rezultateve reale dhe rehabilituese. Në Shqipëri dhe Kosovë, fleksibiliteti është i parashikuar ligjërisht, por zbatimi praktik nuk është gjithmonë konsistent për shkak të mungesës së infrastrukturës së specializuar dhe përvojës së kufizuar të gjyqtarëve dhe punonjësve socialë.

Kufizimet e veçanta dhe detyrimet specifike përbëjnë një tjetër pikë krahasuese. Të katër vendet përdorin masa të kontrollit të sjelljes, si ndalime kontakti me persona të caktuar, kufizime lëvizjeje ose qëndrim nën mbikëqyrje familjare. Megjithatë, në Itali, këto masa janë të kombinuara në mënyrë të strukturuar me programe edukative dhe terapeutike, duke i dhënë të miturit jo vetëm detyrime, por edhe mbështetje për zhvillim personal dhe profesional.

Në Kroaci, ndjekja e programeve arsimore dhe këshillimi është gjithashtu i integruar me mbikëqyrjen sociale, ndërsa në Kosovë dhe në Shqipëri kjo ndarje dhe koordinimi midis programeve dhe mbikëqyrjes është më pak i konsoliduar.

Një dallim tjetër lidhet me përqendrimin mbi parandalimin e recidivizmit. Sistemet e Italisë dhe Kroacisë kanë fokus të thelluar në uljen e rikthimit të të miturve në veprimtari devijante, duke kombinuar kontrollet institucionale me mbështetje institucionale, mbështetje psikologjike, aktivitete sociale dhe këshillim. Në Kosovë dhe Shqipëri, parandalimi i recidivizmit është pjesë e objektivave, por efektiviteti varet shumë nga burimet dhe përvoja e institucioneve përkatëse. Megjithatë, qasja e përgjithshme në të katër vendet mbetet e orientuar drejt rehabilitimit dhe integrimit shoqëror, duke shmangur masat represive të panevojshme.

Në përmbledhje, veçoritë e përbashkëta përfshijnë: **qasjen edukative, mbështetjen e familjes, pjesëmarrjen e të miturit në programe edukative/ profesionale dhe përdorimin e**

kufizimeve të sjelljes si instrument mbikëqyrjeje. Dallimet kryesore lidhen me strukturën institucionale, fleksibilitetin e masave, integrimin e programeve mbështetëse dhe fokusin ndaj parandalimit të recidivizmit. Sistemet e Italisë dhe Kroacisë shfaqin një qasje më të konsoliduar dhe efektive, ndërsa Kosova dhe Shqipëria po zhvillojnë kapacitetet e tyre duke marrë mësime nga përvojat e vendeve me traditë më të gjatë në drejtësinë për të mitur. Ky krahasim tregon qartë se mbikëqyrja e shtuar arrin rezultat maksimal kur kombinohet kontrolli juridik dhe mbështetjen edukative dhe sociale dhe kur gjykata ka kompetencë për rishikim të vazhdueshëm të masave.

Në përfundim, krahasimi i katër sistemeve tregon se masat e mbikëqyrjes së shtuar arrijnë rezultat maksimal kur kombinimi i kontrolleve, edukimit dhe mbështetjes sociale është i harmonizuar dhe i monitoruar vazhdimisht. Sistemet e Italisë dhe Kroacisë shfaqin shembuj të suksesshëm të kësaj qasjeje, ndërsa Kosova dhe Shqipëria mund të përfitojnë nga përvojat e tyre duke zhvilluar kapacitetet dhe strukturat institucionale. Ky krahasim është i rëndësishëm për formësimin e politikave të reja dhe përmirësimin e praktikave ekzistuese, duke e bërë drejtësinë për të mitur më efektive dhe të drejtë për të gjithë pjesëmarrësit.

5. Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve sipas akteve ndërkombëtare

Sipas standardeve ndërkombëtare të promovuara nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), në trajtimin e të miturve që bien ndesh me ligjin duhet t'i jepet përparësi masave alternative ndaj privimit të lirisë. Këto masa synojnë rehabilitimin, riintegrimin social dhe mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës, duke respektuar dinjitetin dhe të drejtat e tij. Në këtë kuadër, masat e mbikëqyrjes së shtuar konsiderohen si mekanizma të përshtatshëm që mundësojnë edukimin, mbikëqyrjen dhe mbështetjen e të miturit në komunitet, duke shmangur kur është e mundur vendosjen e tij në institucione të mbyllura.

"Këto parime mbështeten në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Rregullat e Pekinit (United Nations Standar Minimum Rules for the Administration of Juvenile Justice), Udhëzimet e Riadit (United Nations Guidelines for the Prevention of Juvenile Delinquency) dhe Rregullat e Havanës (United Nations Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty), të cilat

theksojnë se privimi i lirisë duhet të përdoret vetëm si masë e fundit dhe për kohën më të shkurtë të mundshme."[38]

Një ndër instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e drejtësisë për të mitur janë Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit, 1985). Këto rregulla mbështeten në parimin se reagimi ndaj të miturve që kanë kryer vepra penale duhet të jetë fleksibil, proporcional dhe i përshtatur me nevojat individuale të secilit fëmijë. Ato nxisin përdorimin e masave alternative ndaj dënimeve tradicionale, si mbikëqyrja, këshillimi, udhëzimi dhe përfshirja e programeve edukative e sociale. Në këtë kuadër, mbikëqyrja e shtuar konsiderohet një mekanizëm i përshtatshëm për mbikëqyrjen e sjelljes së të miturit brenda komunitetit, duke ruajtur një ekuilibër ndërmjet mbrojtjes së interesit publik dhe garantimit të zhvillimit, edukimit dhe rehabilitimit të të miturit.

Po ashtu, Rregullat e Pekinit i kushtojnë rëndësi të veçantë shmangies së institucionalizimit dhe përcaktojnë se privimi nga liria duhet të përdoret vetëm si mjet i fundit dhe për periudhën më të shkurtër të mundshme. Në këtë aspekt, masat e mbikëqyrjes së shtuar paraqiten si një alternativë efektive ndaj burgimit, pasi i mundësojnë të miturit të vazhdojë procesin arsimor, të ruajë marëdhëniet familjare dhe të mbetet i integruar në komunitet, duke qenë njëkohësisht nën mbikëqyrjen e institucioneve kompetente.[39]

Një parim i përbashkët që përshkon të gjitha instrumentet ndërkombëtare është rëndësia e familjes dhe komunitetit në procesin e rehabilitimit të të miturit. Këto dokumente theksojnë se efektiviteti i masave të mbikëqyrjes së shtuar lidhet ngushtë me përfshirjen aktive të familjes, e cila konsiderohet si mjedisi kryesor për edukimin dhe socializimin e fëmijës. Në të njejtën kohë, komuniteti dhe institucionet përkatëse kanë rol të rëndësishëm për mbështetjen e procesit të riintegrimit. Ky parim është reflektuar edhe në legjislacionet e vendeve të analizuara, veçanërisht në sistemet juridike të Italisë dhe Kroacisë.[40]

---

[38] OHCHR. (n.d). Children in the administration of justice. https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/guidelines-action-children-criminal-justice-system.

[39] United Nations, *Standard Minimum Rules for the Administration of Juvenile Justice (The Beijing Rules)*, GA Res. 40/33 (29 November 1985), rr. 5–17, https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/united-nations-standard-minimum-rules-administration-juvenile-justice-beijing-rules.

[40] Council of Europe, *European Rules for Juvenile Offenders Subject to Sanctions or Measures* (2008), rr. 10–16, https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805d2711.

Një tjetër parim i rëndësishëm ndërkombëtar është rishikimi periodik i masave. Instrumentet ndërkombëtare kërkojnë që masat e mbikëqyrjes së shtuar të mos mbeten të pandryshuara gjatë gjithë periudhës së zbatimit, por të rishikohen vazhdimisht në varësi të progresit dhe sjelljes së të miturit. Ky mekanizëm synon të shmangë zgjatjen e panevojshme të masave dhe të garantojë që ato të mbeten gjithmonë në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës.

Përveç rolit të tyre normativ, aktet ndërkombëtare kanë edhe një rëndësi të konsiderueshme praktike në zbatimin e masave të mbikëqyrjes së shtuar. Standardet ndërkombëtare kërkojnë që këto masa të mos kufizohen vetëm në aspektin formal, por të shoqërohen me programe konkrete edukative, këshillim psikologjik dhe mbikëqyrje profesionale të organizuar. Gjithashtu, ato theksojnë domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet gjykatave, prokurorive, shërbimeve sociale, institucioneve arsimore dhe familjes së të miturit, pasi vetëm përmes një qasjeje të koordinuar mund të arrihet rehabilitimi i suksesshëm dhe të parandalohet përsëritja e sjelljeve kriminale.[41]

[41] Geraldine Van Bueren, *The International Law on the Rights of the Child* (The Hague, 1998), 169.

Kapitulli III

MASAT E MBIKËQYRJES SË SHTUAR NDAJ TË MITURVE NË GJYKATËN THEMELORE TË GJILANIT GJATË PERIUDHËS 2020-2024

1. Numri dhe dinamika e masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve

Sipas të dhënave të Departamentit për të Mitur të Gjykatës Themelore në Gjilan gjatë periudhës 2020-2024, ndaj të miturve janë shqiptuar gjithsej 323 masa të mbikëqyrjes së shtuar.

Tabela 1

Numri i rasteve për të cilat janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve përgjatë viteve 2020, 2021, 2022, 2023, 2024

Viti	Numri i rasteve	Përqindja
2020	40	12.4%
2021	26	8.0%
2022	41	12.7%
2023	119	36.8%
2024	97	30.0%

Burimi: Evidencat e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur (2020-2024); përpunuar nga autorja


Sipas të dhënave të paraqitura në tabelë, rezulton se gjatë vitit 2020 masat e mbikëqyrjes së shtuar janë shqiptuar në 40 raste që përbëjnë (12.4%) të numrit të përgjithshëm të rasteve. Në vitin 2021 është shënuar numri më i ulët, me 26 raste (8,0%), që paraqet edhe numrin më të ulët gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2022, janë evidentuar 41 raste (12.7%), ndërsa rritja më e madhe është vërejtur në vitin 2023, me 119 raste (36.8%), që përbën numrin më të madh të rasteve. Në vitin 2024 janë evidentuar 97 raste (30.0%), duke shënuar një rënie krahasuar me vitin 2023.

Nga kjo analizë mund të konstatohet se gjatë viteve të fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të shqiptimit të masave të mbikqyrjes së shtuar, veçanërisht në vitin 2023, gjë që mund të lidhet me rritjen e rasteve të përfshirjes së të miturve në veprat penale ose me përdorimin më të shpeshtë të kësaj mase edukative nga ana e Gjykatës.

Kjo gjendje, pasqyruar në formën grafike duket kështu:

Grafikoni 1

Paraqitja e numrit të rasteve (2020-2024)



Burimi: Evidencat e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur (2020-2024); përpunuar nga autorja

Edhe nga pasqyrimi i të dhënave të përfshira në këtë grafikun vërehet se numri i rasteve ka qenë më i ulët në vitet 2020, 2021, dhe 2022, ndërsa një rritje e theksuar e rasteve paraqitet në vitin 2023.

Në vitin 2024, numri i rasteve mbetet relativisht i lartë, megjithëse shënon një rënie të lehtë krahasuar më vitin 2023. Këto të dhëna tregojnë se gjatë periudhës së analizuar ka pasur një tendencë të rritjes së rasteve të shqiptimit të masës së mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve, gjë që tregon edhe përdorimin me të shpeshtë të kësaj mase edukative nga ana e Gjykatës në trajtimin e të miturve që kanë kryer vepra penale.[42]

Kjo gjendje tregon se masat e mbikëqyrjes së shtuar vazhdojnë të kenë rol të rëndësishëm në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, duke synuar edukimin dhe rehabilitimin e tyre.

Analiza e dinamikës së shqiptimit të masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve tregon se këto masa paraqesin një instrument të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë për të mitur. Përmes tyre synohet që të miturit të orientohen drejtë sjelljeve të pranueshme shoqërore dhe të

[42] Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur, *Evidenca zyrtare (2020–2024)*, Gjilan, të dhëna të pa publikuara.

parandalohet përsëritja e veprave penale. Kjo masë ka karakter edukativ dhe rehabilitues, pasi që përmes mbikëqyrjes dhe udhëzimit të të miturit synohet përmirësimi i sjelljes së tij dhe integrimi në shoqëri.

Rritja e numrit të rasteve në vitet e fundit mund të tregojë edhe një qasje më të theksuar të organeve të drejtësisë për të shqiptuar më shumë masa edukative në vend të masave më të rënda ndëshkuese ndaj të miturve. Në këtë mënyrë synohet që të miturit të kenë mundësi për rehabilitim dhe zhvillim të drejtë social, duke shmangur pasojat që mund të shkaktojë zbatimi i sanksioneve më të rënda penale.

Duke pasur parasysh dinamikën e shqiptimit të këtyre masave gjatë periudhës së analizuar, është me rëndësi të shqyrtohen edhe veprat penale për të cilat janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve.[43]

2. Veprat penale për të cilat janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar

Siç është theksuar më lartë masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve mund të shqiptohen nga gjykata në rastet kur vlerësohet se përmes mbikëqyrjes dhe udhëzimit mund të arrihet edukimi dhe rehabilitimi i të miturit pa qenë e nevojshme shqiptimi i masave më të rënda. Sipas rezultateve të këtij punimi, në praktikën gjyqësore të Gjykatës Themelore të Gjilanit këto masa zakonisht janë shqiptuar për vepra penale që kanë rrezikshmëri më të ulët shoqërore.

Nga analiza e rasteve të trajtuara në Gjykatën Themelore në Gjilan gjatë periudhës 2020-2024, rezulton se masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve janë shqiptuar për një numër të ndryshëm veprash penale të parashikuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Ndër veprat penale për të cilat më së shpeshti janë shqiptuar këto masa përfshihen: veprat penale kundër pasurisë, siç janë: vjedhja, vjedhja e rëndë, vjedhja e pyllit dhe asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë. Përveç këtyre, në praktikën gjyqësore janë evidentuar edhe raste të veprave penale kundër jetës dhe trupit, siç është: lëndimi i lehtë trupor, si dhe raste të pjesëmarrjes në rrahje dhe sulmit.

Gjithashtu, nga të dhënat e siguruara rezulton se masat e mbikëqyrjes së shtuar janë shqiptuar edhe për vepra të tjera penale, siç janë: kanosja, posedimi i paautorizuar i narkotikëve,

[43] Po aty.

fotografimi dhe inçizimi i paautorizuar, dhuna në familje, mbajtja në pronësi apo posedim i paautorizuar i armëve, si dhe rrezikimi i trafikut publik dhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm.

Kjo tregon se Gjykata Themelore e Gjilanit në praktikën e saj i ka shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar si një instrument edukativ dhe rehabilitues ndaj të miturve, sidomos në rastet kur është vlerësuar se përmes mbikëqyrjes dhe udhëzimit mund të arrihet përmirësimi i sjelljes së tyre dhe riintegrimi në shoqëri.

Në tabelën vijuese do të pasqyrohen veprat penale për të cilat të miturve Gjykata Themelore e Gjilanit u ka shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar.

Tabela 2

Veprat penale për të cilat janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve

Nr.	**Neni**	**Vepra penale**	**Nr. i rasteve**
1	269	Posedimi i paautorizuar i narkotikëve	28
2	181	Kanosja	14
3	185	Lëndim i lehtë trupor	62
4	349	Vjedhja e pyllit	22
5	315	Vjedhja e rëndë	16
6	321	Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë	20
7	313	Vjedhja	16
8	184	Sulmi	33
9	202	Fotografimi dhe inçizimi i paautorizuar	20
10	248	Dhuna në familje	16
11	366	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	21
12	370	Rrezikimi i trafikut publik	15
13	356	Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm	23
14	187	Pjesëmarrja në rrahje	17
Gjithsej			323

Burimi: Evidencat e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur (2020-2024); përpunuar nga autorja

Nga të dhënat e parashtruara në këtë tabelë vërehet se gjatë periudhës 2020-2024, Gjykata Themelore e Gjilanit ka shqiptuar masa të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve për veprën penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve në 28 raste, për veprën penale kanosje në 14 raste, për veprën penale lëndim i lehtë trupor në 62 raste, për veprën penale vjedhja e pyllit në 22 raste, për veprën penale vjedhja e rëndë në 16 raste, për veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë në 20 raste, për veprën penale vjedhja në 16 raste, për veprën penale sulmi në 33 raste, për veprën penale

fotografimi dhe inçizimi i paautorizuar në 20 raste, për veprën penale dhuna në familje në 16 raste, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të autorizuar të armëve në 21 raste, për veprën penale rrezikimi i trafikut publik në 15 raste, për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm në 23 raste, për veprën penale pjesëmarrja në rrahje në 17 raste.[44]

3. Disa të dhëna personale të të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar

Masat e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve shqiptohen nga gjykata duke marrë parasysh jo vetëm interesin më të mirë të miturit, por edhe veprën penale të kryer dhe karakteristikat personale dhe sociale të të miturit. Për këtë arsye është me rëndësi të analizohen disa të dhëna personale të të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar këto masa gjatë periudhës së analizuar.

Analiza e këtyre të dhënave ndihmon në krijimin e një pasqyre më të qartë mbi profilin e të miturve që kanë qenë subjekt i masave të mbikëqyrjes së shtuar në Gjykatën Themelore në Gjilan. Në këtë drejtim do të analizohen disa elemente të rëndësishme si: mosha, gjinia, niveli i shkollimit dhe statusi social e familjar i të miturve.

3.1. Mosha

Me kriminalitet të të miturve do të kuptojmë tërësinë e veprave penale të kryera nga persona që kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe janë nën 18 vjeç.

Megjithatë, kufiri i fillimit të moshës së përgjegjësisë penale ka rëndësi dhe ndikon në vëllimin e kriminalitetit të të miturve dhe në krahasimin e tij nga një vit në tjetrin dhe mes vendeve të ndryshme. Në vende të ndryshme, kufiri moshor i fillimit të përgjegjësisë penale është i ndryshëm. Ai varion nga mosha 10 vjeç në 13, 14, 15 dhe në ndonjë vend në moshën 16 vjeç.

Niveli i fillimit të përgjegjësisë penale është i lidhur ngushtë me natyrën e sistemit të drejtësisë penale dhe me masat mbrojtëse që shtetet marrin ndaj të miturve. Në disa shtete ku legjislacioni ka parashikuar një moshë të ulët të fillimit të përgjegjësisë penale, ndaj të miturve zbatohen vetëm masa edukuese dhe jo dënim me heqje lirie.[45]

[44] Po aty.
[45] Vasilika Hysi, *Kriminologjia* (Tiranë, 2010), fq. 238.

Analiza sipas grupmoshave e rasteve të shqiptimit të masave të mbikëqyrjes së shtuar ndihmon në identifikimin e moshave në të cilat paraqitet më shpesh përfshirja e të miturve në kryerjen e veprave penale. Kjo analizë është e rëndësishme pasi mund të tregojë se në cilën periudhë të zhvillimit të tyre të miturit janë më të ekspozuar ndaj sjelljeve të kundërligjshme.

Analiza e moshës së të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar paraqet një element të rëndësishëm për të kuptuar më mirë strukturën e të miturve të përfshirë në kryerjen e veprave penale. Përmes kësaj analize mund të identifikohen grupmoshat në të cilat paraqitet më shpesh përfshirja e të miturve në sjellje të kundërligjshme.

Në bazë të të dhënave të siguruara nga Gjykata Themelore në Gjilan për periudhën 2020-2024, rezulton se masat e mbikëqyrjes së shtuar janë shqiptuar ndaj të miturve të lindur në vite të ndryshme, duke filluar nga viti 2002 deri në vitin 2009.

Në vazhdim, në tabelë të veçantë, do të prezantohet mosha e të miturve ndaj të cilëve Gjykata Themelore e Gjilanit gjatë periudhës 2020-2024 ka shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar

Tabela 3
Mosha (viti i lindjes) e të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar

Viti i lindjes	***Numri i rasteve***
2002	18
2003	23
2004	29
2005	41
2006	50
2007	83
2008	60
2009	19
Gjithsej	323

Burimi: Evidencat e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur (2020-2024); përpunuar nga autorja

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë vërehet se numri më i madh i rasteve i përket të miturve të lindur në vitin **2007**, me gjithsej **83 raste**. Një numër relativisht i lartë i rasteve paraqitet edhe tek të miturit e lindur në vitin **2008**, me **60 raste**, si dhe tek ata të lindur në vitin **2006** me **50 raste**.


Ndërsa, numri më i vogël i rasteve paraqitet tek të miturit e lindur në vitin **2009**, me **19 raste** si dhe tek ata të lindur në vitin **2002**, me **18 raste**.

Këto të dhëna tregojnë se përfshirja në kryerjen e veprave penale është më e theksuar tek të miturit e moshave më të afërta me moshën madhore.[46]

Kjo pasqyrë dëshmon se masat e mbikëqyrjes së shtuar janë shqiptuar pothuajse në mënyrë të barabartë ndaj të miturve të grupmoshave 14-16 vjeç dhe 16-18 vjeç. Nga analiza e të dhënave rezulton se në grupmoshën 14-16 vjeç janë evidentuar gjithsej 162 raste, ndërsa në grupmoshën 16-18 vjeç gjithsej 161 raste. Kjo tregon se kryerja e veprave penale dhe shqiptimi i masave të mbikëqyrjes së shtuar nuk paraqet dallime të theksuara ndërmjet këtyre dy grupmoshave të të miturve.

Në këndvështrim të grafikut, të dhënat e tilla duken kështu:

Grafikoni 2
Mosha e të miturve



Burimi: Evidencat e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur (2020-2024); përpunuar nga autorja

Këto të dhëna tregojnë se përfshirja në kryerjen e veprave penale është më e theksuar tek të miturit që janë në moshë më të afërt me moshën madhore.

[46] Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur, *Evidencat zyrtare (2020–2024)*, Gjilan, të dhëna të brendshme administrative.

3.2. Gjinia

Gjinia paraqet një karakteristikë demografike që tregon përkatësinë e individit në kategorinë mashkull ose femër dhe përdoret në analiza të ndryshme statistikore dhe shoqërore për të evidentuar dallimet ndërmjet grupeve të popullsisë.

Gjinia luan një rol thelbësor në analizimin e shkaktarëve, llojeve dhe frekuencës së veprave penale, dhe është një nga faktorët kryesor për të kuptuar pse dhe si kryhen krimet, si dhe dallimet mes sjelljes kriminale të burrave dhe grave.

K**riminologjia e trajton gjininë përmes disa dimensioneve kryesore:**

- Diferencat në shkallën e kriminalitetit: Statistikat kriminologjike tregojnë vazhdimisht se meshkujt kryejnë më shumë vepra penale se femrat, veçanërisht në krimet e dhunshme.

- Llojet e veprave penale: Meshkujt priren të përfshihen më shumë në krime që përfshijnë dhunë fizike dhe agresion. Nga ana tjetër, femrat priren të kryejnë krime që përkojnë me pozicionin e tyre social apo mundësitë (p.sh., mashtrime të vogla, vjedhje të lehta ose krime ekonomike).

- Teoritë e socializimit: Kriminologët shpjegojnë këto dallime përmes roleve gjinore, ku meshkujt shpesh socializohen për të qenë më agresiv ose për të marrë më shumë rreziqe krahasuar me femrat.

- Pozita e viktimës: Kuptimi i gjinisë ndihmon edhe në studimin e viktimologjisë, duke identifikuar se si gratë janë më të ndjeshme ndaj llojeve të caktuara të krimeve, siç është dhuna në familje apo krimet seksuale.

Analiza e gjinisë së të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar paraqet një element të rëndësishëm për të kuptuar strukturën e përfshirjes së të miturve në kryerjen e veprave penale. Në këtë kuadër është analizuar përkatësia gjinore e të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar këto masa gjatë periudhës 2020-2024 në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Nga të dhënat e siguruara nga regjistrat penal të Departamentit për të Mitur rezulton se në gjitha rastet ndaj të cilat janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar gjatë periudhës hulumtuese, të miturit kanë qenë të gjinisë mashkullore. Kjo tregon se në praktikën e trajtuar në këtë gjykatë nuk janë evidentuar raste të shqiptimit të kësaj mase ndaj të miturve femra gjatë kësaj periudhe. Ky fakt mund të lidhet me përfshirjen më të shpeshtë të të miturve meshkuj në kryerjen e veprave

penale, fenomen i cili është evidentuar edhe në studime të ndryshme kriminologjike, ku meshkujt paraqiten më shpesh si kryes të veprave penale në krahasim me femrat.[47]

Në tabelën vijuese do të pasqyrohet gjinia e të miturve ndaj të cilëve Gjykata Themelore e Gjilanit, gjatë periudhës 2020-2024 ka shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar.

Tabela 4

Gjinia e të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar

Gjinia	Numri i rasteve
Meshkuj	323
Femra	0
Gjithsej	323

Burimi: Evidencat e Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur (2020-2024); përpunuar nga autorja

3.3. Niveli arsimor

Shkollimi paraqet një nga faktorët e rëndësishëm social që ndikon në zhvillimin dhe integrimin e të miturve në shoqëri. Analiza e nivelit të arsimimit të të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat edukative ndihmon në kuptimin më të mirë të rrethanave sociale dhe edukative që mund të kenë ndikuar në përfshirjen e tyre në kryerjen e veprave penale.

Në kuadër të kësaj analizë janë shqyrtuar të dhënat lidhur me nivelin e shkollimit të të miturve ndaj të cilëve është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së shtuar gjatë periudhës 2020-2024, në Gjykatën Themelore në Gjilan. Nga të dhënat e siguruara, ndonëse ato në të shumtën e rasteve nuk e pasqyrojnë këtë element, rezulton se shumica e të miturve kanë qenë në proces të ndjekjes së arsimit fillor ose të mesëm në kohën kur është shqiptuar masa edukative ndaj tyre.

Në disa raste është evidentuar se të miturit kanë pasur vështirësi në vijimin e rregullt të procesit mësimor, duke përfshirë mungesa të shpeshta në shkollë ose ndërprerje të përkohshme të shkollimit. Këto rrethana shpesh lidhen me faktorë të ndryshëm social dhe familjarë, të cilët mund të ndikojnë në sjelljen dhe zhvillimin e të miturve.

Analiza e nivelit të shkollimit tregon rëndësinë e rolit të institucioneve arsimore në parandalimin e devijimit të sjelljes së të miturve dhe në integrimin e tyre në shoqëri. Për këtë arsye,

[47] Hysi, *vep. e cit.*, fq. 171-172.

bashkëpunimi ndërmjet institucioneve arsimore, familjes dhe institucioneve të drejtësisë konsiderohet i domosdoshëm për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm të të miturve në shoqëri.[48]

3.4. Statusi social e familjar

Statusi social e familjar paraqet një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në zhvillimin dhe formimin e personalitetit të të miturve. Mjedisi familjar, kushtet ekonomike, si dhe marrëdhëniet brenda familjes luajnë një rol të rëndësishëm në sjelljen dhe orientimin e të miturve në shoqëri.

Në kuadër të analizës së të dhënave për periudhën 2020-2024, në Gjykatën Themelore në Gjilan janë shqyrtuar edhe rrethanat familjare të të miturve ndaj të cilëve është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së shtuar. Nga të dhënat e evidentuara ndonëse me shumë mangësi rezulton se të miturit vijnë nga mjedise të ndryshme familjare, duke përfshirë familje me gjendje të ndryshme ekonomike dhe sociale.

Në disa raste është vërejtur se faktorë të tillë: si mungesa e mbikëqyrjes së mjaftueshme prindërore, problemet ekonomike ose konfliktet familjare mund të ndikojnë në sjelljen e të miturve dhe në përfshirjen e tyre në kryerjen e veprave penale. Për këtë arsye, roli i familjes konsiderohet shumë i rëndësishëm në procesin e edukimit dhe zhvillimit të të miturve.

Në anën tjetër të dhënat provojnë se të miturit dhe familjarët e tyre ndaj të cilëve janë shqiptuar këto masa kryesisht kanë qenë të papunësuar.

Nga analiza e të dhënave personale të të miturve ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar rezulton se faktorë të ndryshëm social dhe familjarë mund të kenë ndikim në sjelljen e tyre dhe në kryerjen e veprave penale. Për këtë arsye, trajtimi i të miturve në sistemin e drejtësisë për të mitur duhet të ketë për qëllim jo vetëm ndëshkimin, por edukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.[49]

[48] Halili, *vep. e cit.*, fq. 125.
[49] Salihu, *vep. e cit.*, fq. 40.

Përfundime dhe rekomandime

Përfundimet:

Në këtë punim është trajtuar çështja e masave edukative të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve në sistemin e drejtësisë për të mitur në Republikën e Kosovës, me fokus të veçantë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Themelore në Gjilan gjatë periudhës 2020-2024. Trajtimi i kësaj teme ka pasur për qëllim analizimin e rolit dhe rëndësisë së këtyre masave në procesin e trajtimit dhe rehabilitimit të të miturve që kanë kryer vepra penale.

Nga analiza teorike rezulton se sistemi i drejtësisë për të mitur bazohet në parimin e mbrojtjes dhe edukimit të të miturve, duke synuar para se gjithash rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Për dallim nga sistemi penal për të rriturit, ku theksi vihet më shumë te ndëshkimi, në drejtësinë për të mitur, rëndësi e veçantë i kushtohet masave edukative, të cilat kanë për qëllim korrigjimin e sjelljes së të miturit dhe parandalimin e përsëritjes së veprave penale.

Masat e mbikëqyrjes së shtuar paraqesin një nga masat edukative më të rëndësishme që aplikohen ndaj të miturve në konflikt me ligjin. Këto masa kanë për qëllim mbikëqyrjen dhe orientimin e të miturit në mënyrë që ai të zhvillojë sjellje të pranueshme shoqërore dhe të shmangë përfshirjen e mëtejshme në aktivitete të kundërligjshme. Në këtë drejtim, roli i institucioneve të drejtësisë, familjes dhe institutcioneve arsimore është shumë i rëndësishëm për zbatimin efektiv të këtyre masave.

Nga analiza e të dhënave statistikore të siguruara nga Gjykata Themelore në Gjilan rezulton se gjatë periudhës 2020-2024, janë shqiptuar gjithsej 323 raste të masave të mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturve. Numri i rasteve ka ndryshuar nga viti në vit, ku vërehet një rritje e konsiderueshme e rasteve në vitin 2023. Këto të dhëna tregojnë se fenomeni i përsëritjes së të miturve në veprime të kundërligjshme vazhdon të jetë një çështje me rëndësi për institucionet e drejtësisë dhe për shoqërinë në përgjithësi.

Analiza e veprave penale për të cilat janë shqiptuar këto masa tregon se të miturit më së shpeshti janë përfshirë në vepra penale kundër pasurisë, siç janë: vjedhja dhe vjedhja e rëndë. Përveç këtyre, janë evidentuar edhe raste të veprave penale kundër jetës dhe trupit, si lëndimi i lehtë trupor dhe pjesëmarrja në rrahje, si dhe disa vepra të tjera penale të natyrës së ndryshme.

Nga analiza e të dhënave personale të të miturve rezulton se përfshirja në veprime të kundërligjshme është më e theksuar tek të miturit meshkuj. Në rastet e analizuara në këtë punim, të gjithë të miturit ndaj të cilëve janë shqiptuar masat e mbikëqyrjes së shtuar kanë qenë të gjinisë mashkullore. Kjo tregon se fenomeni i përfshirjes në kriminalitet paraqitet më shpesh tek meshkujt se femrat.

Gjithashtu, analiza e moshës së të miturve tregon se përfshirja në kryerjen e veprave penale është më e theksuar në periudhën e adoleshencës së vonshme, kur të miturit janë më afër moshës madhore. Kjo periudhë karakterizohet nga ndryshime të shumta psikologjike dhe sociale, të cilat mund të ndikojnë në sjelljen dhe vendimmarrjen e të rinjve.

Bazuar në analizën e realizuar në këtë punim mund të konstatohet se masat e mbikëqyrjes së shtuar paraqesin një instrument të rëndësishëm në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Përmes këtyre masave synohet jo vetëm ndëshkimi i të miturit për veprën e kryer, por edhe ndikimi pozitiv në zhvillimin dhe edukimin e tij, me qëllim që ai të riintegrohet në shoqëri dhe të mos përsëris veprat penale në të ardhmen.

Rekomandimet:

Duke u bazuar në analizën teorike dhe praktike të realizuar në këtë punim, mund të paraqiten disa rekomandime që kanë për qëllim përmirësimin e sistemit të trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin dhe rritjen e efektivitetit të masave edukative në praktikë.

Së pari, është e rëndësishme që institucionet e drejtësisë të vazhdojnë të aplikojnë masa edukative ndaj të miturve, duke i dhënë përparësi rehabilitimit dhe riintegrimit të tyre në shoqëri. Shqiptimi i masave edukative, siç është masa e mbikëqyrjes së shtuar ndihmon në korrigjimin e sjelljes së të miturve dhe në parandalimin e përsëritjes së veprave penale.

Së dyti, është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndryshme që merren me trajtimin e të miturve, duke përfshirë gjykatat, prokurorinë, qendrat për punë sociale, institucionet arsimore dhe organizatat tjera relevante. Një bashkëpunim i tillë do të mundësonte një trajtim më të koordinuar dhe më efektiv të rasteve që përfshijnë të miturit.

Së treti, institucionet arsimore duhet të kenë një rol më aktiv në parandalimin e devijimit të sjelljes së të miturve. Shkolla paraqet një nga mjediset më të rëndësishme për edukimin dhe zhvillimin e të rinjve, prandaj është e rëndësishme për edukimin dhe zhvillimin e të rinjve, prandaj është shumë e rëndësishme që institucionet arsimore të zhvillojnë programe të ndryshme edukative dhe sensibilizuese për nxënësit lidhur me pasojat e përfshirjes në veprime të kundërligjshme.

Së katërti, familja duhet të luajë një rol më të madh në mbikëqyrjen dhe edukimin e të miturve. Prindërit dhe anëtarët e familjes kanë ndikim të drejtpërdrejtë në formimin e sjelljes dhe vlerave të rinjve, prandaj është e rëndësishme që ata të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e edukimit dhe mbikëqyrjes së fëmijëve të tyre.

Së pesti, institucionet shtetërore duhet të vazhdojnë të zhvillojnë politika dhe programe që synojnë parandalimin e kriminalitetit tek të miturit. Këto politika duhet të fokusohen jo vetëm në reagimin ndaj veprave penale, por edhe në identifikimin dhe trajtimin e faktorëve që mund të ndikojnë në përfshirjen e të miturve në aktivitete të kundërligjshme.

Në përfundim, trajtimi i të miturve në konflikt me ligjin kërkon një qasje të balancuar ndërmjet drejtësisë dhe edukimit. Përmes bashkëpunimit të institucioneve të ndryshme dhe përmes aplikimit të masave edukative, është e mundur të arrihet rehabilitimi i të miturve dhe integrimi i tyre i suksesshëm në shoqëri.

Bibliografia

Libra dhe artikuj shkencorë

Cvitanović, Lovro. *Masat edukuese në të drejtën penale*. Zagreb, 2020.

De Leo, Gaetano. *Parandalimi i recidivizmit te të miturit*. Bolonjë, 2020.

Elezi, Ismet; Kaçupi, Skënder; Haxhia, Maksim. *E drejta penale*. Tiranë, 2008.

Hajdari, Azem. *E drejta e procedurës penale e të miturve (me Ligjin Penal për të Mitur)*. Prishtinë, 2005.

Hajdari, Azem. *Sistemi i drejtësisë për të mitur*. Prishtinë, 2010.

Halili, Ragip. *Penologjia*. Prishtinë, 2005.

Horvatić, Željko. *Sistemi i sanksioneve ndaj të miturve*. Zagreb, 2019.

Hysi, Vasilika. *Kriminologjia*. Tiranë, 2010.

Kambovski, Vlado. *E drejta penale*. Shkup, 2004.

Kodra, Elira. *Drejtësia penale për të mitur në Shqipëri*. Tiranë, 2019.

Moro, Alberto. *Procedura penale për të mitur*. Milano, 2017.

Muçaj, Artan. *Kodi i drejtësisë penale për të mitur*. Tiranë, 2020.

Novoselec, Petar. *E drejta penale për të rinjtë*. Zagreb, 2018.

Padovani, Tullio. *Masat edukative në sistemin penal për të mitur*. Milano, 2019.

Qato, Mimoza. *Zbatimi i masave alternative për të miturit në Shqipëri*. Tiranë, 2021.

Salihu, Ismet. *E drejta penale për të mitur*. Prishtinë, 2018.

Salihu, Ismet. *E drejta penale – pjesa e përgjithshme*. Prishtinë, 2020.

Salihu, Ismet; Zhitia, Hilmi; Hasani, Fejzullah. *Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës*. Prishtinë, 2014.

Van Bueren, Geraldine. *E drejta ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës*. Haga, 1998.

Akte juridike

Republika e Kosovës, *Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur*. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Organizata e Kombeve të Bashkuara. *Konventa për të Drejtat e Fëmijës*.

Organizata e Kombeve të Bashkuara. *Rregullat standarde minimale për administrimin e*

drejtësisë për të mitur (Rregullat e Pekinit), 1985.
Këshilli i Evropës. *Rregullat evropiane për të miturit e përfshirë në masa ose sanksione*, 2008.

Burime të tjera

Misioni i OSBE-së në Kosovë. *Raport mbi drejtësinë për të mitur dhe masat alternative*. Prishtinë, 2019.
Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur. *Evidenca statistikore (2020–2024)*. Të dhëna të brendshme (të pabotuara).